



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 56/2023 regjistër (JR)
Datë 01.12.2023

Nr. 49 i vendimit
Datë 22.10.2024

V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjyqësor i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Albana Shtylla	Kryesuese
Ina Rama	Relatore
Sokol Çomo	Anëtar
Mimoza Tasi	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 22.10.2024, ditën e martë në orën 15:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Steven Kessler, me Sekretare Gjyqësore Ina Xhetani, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

ANKUES: Komisionerja Publike, Irena Nino.

OBJEKTI: Kundërshtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 703, datë 28.09.2023, për subjektin e rivlerësimit, znj. Suela Salavaçi, me funksion prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b pika 5 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni C, pika 2, neni F, pika 2 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjyqësor i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e kërkimet e Komisioneres Publike, të paraqitura në ankim dhe në konkluzionet përfundimtare, nëpërmjet të cilave ajo kërkoi

përfundimisht ndryshimin e vendimit objekt shqyrtimi dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Suela Salavaçi dhe dëgjoji subjektin e rivlerësimit, si dhe avokaten e saj Romina Zano, të cilat kërkuan lënien në fuqi të vendimit të Komisionit, dëgjoji gjyqtaren relatores Ina Rama, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Suela Salavaçi (në vijim “subjekti i rivlerësimit), në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 76/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, e ndryshuar, ushtronte detyrën e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe, për shkak të parashikimeve të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës dhe të nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, *ex-officio*.
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), për subjektin e rivlerësimit administroi raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar¹ (në vijim “DSIK”) dhe Prokuroria e Përgjithshme.

2.1 ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Suela Salavaçi, ka dërguar pranë Komisionit raportin² e hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit dhe vlerësimit të pasurisë së subjektit, në të cilin, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, ka konstatuar se: (i) deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin; (ii) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) nuk ka kryer deklaram të rremë; (v) nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2 DSIK-ja i ka përcjellë Komisionit raportin e kontrollit të figurës³, duke konstatuar, bazuar në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Suela Salavaçi.

2.3 Prokuroria e Përgjithshme, për subjektin e rivlerësimit, znj. Suela Salavaçi, i ka përcjellë Komisionit një raport⁴ të hollësishëm për vlerësimin e aftësive profesionale.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Me vendimin nr. 703, datë 28.09.2023, pasi është njohur me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në kriterin e pasurisë dhe figurës dhe nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale. Për rrjedhojë, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në bazë të nenit 51, shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 58 dhe pikës 1 të nenit 59 të

¹Në zbatim të përcaktimeve të ligjit nr. 10/2023, aktualisht ky institucion mban emrin “Autoriteti kombëtar për sigurinë e informacionit të klasifikuar”.

² Me shkresën e nr. {***} prot., datë 16.04.2018.

³ Me shkresën nr. {***} prot., datë 31.10.2017, të deklasifikuar me vendimin nr. {***}, datë 26.05.2021, të KDZh-së.

⁴ Me shkresën nr. {***} prot., datë 07.02.2023.

ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash, Komisioni ka vendosur *konfirmimin* në detyrë të subjektit të rivlerësimit.

III. Shkaqet e ankimit

4. Komisionerja Publike Irena Nino, në konsideratë të “Rekomandim për paraqitje ankimi”⁵, të nënshkruar nga një komision prej tre vëzhguesish ndërkombëtarë të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, ka paraqitur ankim kundër vendimit nr. 703, datë 28.09.2023, të Komisionit. Në ankimin e saj, duke potencuar interesin publik, nëpërmjet kontrollit të vendimit nr. 703, datë 28.09.2023, të Komisionit, nga Kolegji i Posaçëm i Apelit (në vijim “Kolegji”), Komisionerja Publike ka adresuar shkaqe ankimi në drejtim të kriterit të vlerësimit të pasurisë dhe kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale. Në përfundim të ankimit, Komisionerja Publike ka kërkuar ndryshimin e vendimit nr. 703, datë 28.09.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Suela Salavaçi.

A. Shkaqe ankimi lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë

5. Komisionerja Publike ka parashtruar shkaqe që i adresohen verifikimit të deklarimeve dhe kontrollit për krijimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, të cilët kanë deklaruar pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme apo vlera të ndryshme të konsiderueshme, me burim krijimi të ardhurat nga prindërit e subjektit, për pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, përkatësisht: (i) apartament banimi në rrugën “{***}”, Tiranë; (ii) apartament banimi në Golem, Kavajë; (iii) depozitë dyemërore në shumën 67.496 USD; (iv) dy llogaritë e vajzave, deklaruar në deklaratën *vetting* 2017, në shumën totale prej rreth 18.200 USD; (v) shumat 6.000 euro në vitin 2007 dhe 5.000 euro në vitin 2008, 10.000 USD në vitin 2010; (vi) shuma prej 10.000 USD deklaruar dhuruar subjektit dhe poseduar si likuiditet në formën *cash*, në deklaratën *vetting* 2017; (vii) përveç sa më sipër deklaruar, gjatë hetimit administrativ, ka rezultuar se me: **a)** kontratën e dhurimit nr. {***} rep./{***}kol., datë 04.04.2017, subjekti është bërë përfutuese e banesës 2-katëshe në Tiranë, me vlerë të llogaritur sipas EKB-së rreth 7 milionë lekë; dhe **b)** nëpërmjet vendimit të çeljes së trashëgimisë ligjore nr. {***}rep./ {***}kol., datë 05.02.2021, subjekti është bërë përfutuese e pjesës takuese 1/3 të depozitës bankare, në emër të babait pranë Credins Bank, në shumën 60.857 USD, depozitë që e ka origjinën e krijimit në vitin 2003.

6. Për pasuritë e mësipërme, Komisionerja Publike pretendon sa vijon:

6.1. Lidhur me burimet e krijimit të pasurive, subjekti nuk dha shpjegime bindëse dhe nuk provoi të kundërtën e barrës së provës, lidhur me: (i) shtrirjen e analizës financiare të personave të lidhur/tjerë të lidhur, prindërve, vetëm në masën e pasurive të dhuruara rast pas rasti, pasi, sikundër ka rezultuar, gjithë pasuritë e paluajtshme të prindërve, si dhe pjesërisht pasuritë e luajtshme, janë përfutuar nga vetë subjekti i rivlerësimit në formë dhurimi, heqje dorë apo dëshmi trashëgimie; (ii) referuar rastit konkret e rrethanave specifike të krijimit të pasurive, analiza dhe vlerësimi i pasurive do të duhet të bëhet në drejtim të garantimit të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, duke pasur në konsideratë parashikimet e nenit D

⁵ Rekomandimi për ankim i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, nr. {***} prot., datë 08.11.2023.

pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, për sa kohë investimet e prindërve të subjektit, ndër vite, kanë kaluar po në favor të subjektit të rivlerësimit, në një nga format e përmendura më sipër.

6.2. Komisionerja Publike konsideron si jo të drejtë dhe të pambështetur në prova përfshirjen në mesin e burimeve të ligjshme të prindërve të subjektit, për krijimin e pasurive, e shumëve që kanë të bëjnë me:

(i) Të ardhurat e përfituara nga nëna e subjekti, nga pjesa takuese e të afërmes së saj znj. E. Dh. (K.) [tezja e nënës së subjektit], pasi: subjekti i rivlerësimit nuk rezulton t'i ketë deklaruar si burim këto të ardhura në mesin e burimeve të përdorura për krijimin e pasurive në deklaratën *vetting*, në deklaratimet periodike vjetore, dhe as në procesverbalin e mbajtur pranë ILDKPKI-së në vitin 2016. Përveç sa më sipër, për këto të ardhura, të cilat lidhen ngushtësisht me këtë person, në cilësinë e trashëgimtares ligjore të një të afërmeje tjetër [znj. A. S. (K.)], subjekti i rivlerësimit nuk provoi posedimin/kalimin e tyre nga trashëgimtarët e tjerë të nëna e saj, duke mbetur kjo e ardhur në nivel deklarativ dhe jo në harmoni me provat e administruara gjatë procesit.

(ii) Të ardhurat në shumën prej 15.500.000 lekësh, të përfituara nga aktmarrëveshja e lidhur nga nëna e subjektit në datën 29.04.2003 dhe një individ⁶ tjetër, pasi: shuma në fjalë nuk është deklaruar si burim për krijimin e pasurive në deklaratën *vetting*, në deklaratat periodike vjetore dhe as në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI në vitin 2016. Mungesa e dijenisë e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit mbi këtë akt vjen në kundërshtim me sa deklaruar nga subjekti mbi burimet e depozitave të krijuara në vitin 2003 nga prindërit. Gjithashtu, kjo aktmarrëveshje duket se është nënshkruar në kushtet e mungesës së titullit të pronësisë nga nëna e subjektit, nuk provohet ekzekutimi apo arkëtimi i shumës 15.500.000 lekë, si dhe nuk rezulton të jetë pasqyruar në ndonjë nga aktmarrëveshjet e mëvonshme, nënshkruar midis bashkëpronarëve për të njëjtën pronë dhe sipërfaqe (përfshirë dhe të emën e subjektit) dhe shoqërisë “{***}” ShPK.

6.3. Për pasurinë *apartment* banimi në *Golem*, Kavajë, Komisionerja Publike pretendon se, përveç sa më sipërtrajtuar mbi mungesën e burimeve të ligjshme nga prindërit deri në fund të vitit 2005, në konsideratë edhe të kredisë marrë nga e ëma e subjektit, pranë NBG-së, në vitin 2010, dhuruesja nuk provoi burimet e ligjshme për pagesën e këstit të tretë të kryer në vitin 2012.

6.4. Pretendimi i subjektit për disponimin e likuiditetit *cash* në shumën 10.000 euro, deklaruar në deklaratën *vetting*, me burim të ardhurat nga kontrata e shitjes së vitit 2012, mbetet në nivel deklarativ dhe nuk përputhet me aktet në dosje. Deklarimi i subjektit mbi përfshirjen në analizë financiare të shumës prej 14.500 eurosh, duket se është bërë në funksion të përmbysjes së analizës financiare negative të vitit 2015.

6.5. Rezultati i analizës financiare të kryer nga Komisioni për periudhën 2003-2016 ka pasaktësi, që janë pasojë e marrjes në konsideratë të pretendimeve të subjektit për reduktim të shpenzimeve për udhëtime dhe të pretendimeve për konsiderimin e kursimeve në *cash*.

⁶ Z. A. Xh..

B. Shkaqe e ankimit lidhur me vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale

7. Komisionerja Publike pretendon se nga të dhënat e administruara nga burimet e vlerësimit të aftësive profesionale, duket se rezultojnë disa rrethana, të cilat, të analizuara së bashku me rezultatet e tjera të hetimit, si dhe të para në raport me njëra-tjetrën, duhen çmuar nga Kolegji, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, sipas parashikimeve të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Në ankim, këto pretendime lidhen me çështjet në vijim të ndjekura nga subjekti i rivlerësimit. Komisionerja Publike potencon sa vijon:

7.1. Lidhur me dosjen penale nr. {***/2010, ndryshe nga konkluzioni i Komisionit, në analizë të rastit të paraqitur me gjetjen e vëzhguesit ndërkombëtar, e cila përbën provë në këtë proces, dhe në gjendjen që janë aktet në dosje, rezultojnë disa rrethana që duket se afektojnë kriterin e aftësisë profesionale, sipas nënindikatorëve të parashikuar prej nenit 73, pikat 2 dhe 3, si dhe nenit 75, pika 4 e ligjit nr. 96/2016.

7.2. Lidhur me denoncimin e znj. F. Y., që lidhet me procedimin penal nr. {***/2019, për veprat penale “Dhunimi i banesës dhe falsifikim i dokumenteve”, të parashikuar respektivisht nga nenet 186 dhe 112 të Kodit Penal, subjekti nuk ka dhënë shpjegime bindëse mbi mungesën e veprimeve hetimore dhe drejtimin e duhur të tyre, konfirmuar kjo edhe nga kontrolli gjyqësor. Problematikat e konstatuara, në rastin konkret, janë të vlefshme për t’u trajtuar nga Kolegji, sipas kriterëve të ligjit nr. 96/2016, eventualisht së bashku me gjetjet e tjera të shkaqeve të ankimit, nën frymën e nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

7.3. Lidhur me denoncimin e tre individëve nga familja H.⁷, i cili ka të bëjë me procedimin penal nr. {***/2014, për veprën penale “Shpërdorim detyre” të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, subjekti ka treguar mungesë të aftësisë për të kryer me efekt procedurat hetimore dhe procedura të tjera të sistemit të prokurorisë, brenda afateve të përcaktuara të mbledhjes së provave të nevojshme, duke përfshirë dhe mungesën e mbikëqyrjes së dërgimit pa vonesë të akteve të nevojshme të njoftimit, referuar indikatorëve të përcaktuar nga neni 73/2 dhe 3, si dhe neni 74/4 i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” i ndryshuar, (në vijim referuar “ligji nr. 96/2016”).

7.4. Denoncimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit dhe Pastrimit të Parave, që ka të bëjë me procedimin penal nr. {***/2019 të vlerësohet nga Kolegji, së bashku me gjetjet e tjera, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

IV. **Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit**

A. *Mbi aspektet procedurale të gjykimit*

a) *Juridiksioni i Kolegjit*

8. Në zbatim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji i Posaçëm i Apelimit ka juridiksion (*ratione materiae*) të shqyrtojë ankimet kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin kalimtar të subjekteve, i parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Suela Salavaçi, duke pasur për objekt kundërshtimin

⁷ Z. Sh. H., znj. L. B. (H.) dhe znj. L. B. (H.).

e një vendimi të Komisionit, mbi bazën e ankimit të Komisioneres Publike dhe duke mos qenë në kushtet e parashikuara nga neni 5, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit.

b) *Legjitimimi i ankuesit*

9. Komisionerja Publike legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) *Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

10. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi nga Kolegji i ankimit ndaj vendimit objekt ankimi, duke qenë se është ushtruar nga Komisionerja Publike, u zhvillua në seancë gjyqësore publike.
11. Pas regjistrimit të çështjes objekt gjykimi, në Kolegj, janë administruar një sërë denoncimesh⁸. Trupi gjykues vendosi të mos ia nënshtrojë shqyrtimit denoncimet që nuk ishin të shoqëruara me praktikë/akte mbështetëse, duke vlerësuar se ato nuk përmbushnin kërkesat e nenit 53 të ligjit nr. 84/2016.

11.1. Ndër denoncimet e analizuara, ishte ai i përcjellë nga znj. Gj. D., pas shpalljes së vendimit të Komisionit, i cili shoqërohej me akte. Prej tyre rezultoi se për procedimin penal që ishte fokusi i denoncimit [nr. {***}/ 2020], subjekti i rivlerësimit ka kryer një hetim të plotë, duke marrë në pyetje si palët e interesuara, ashtu edhe punonjësit e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës që kanë ndjekur çështjen dhe ka administruar në cilësinë e provës praktikën përkatëse. Edhe zgjidhja e çështjes nga subjekti mbështetet në vlerësimin e bërë rrethanave të dala nga hetimi. Në këto kushte, trupi gjykues vlerësoi se kjo çështje nuk mund të konsiderohet se afekton kriteret e vlerësimit referuar indikatorëve të përcaktuar nga neni 73, pikat 2 dhe 3, si dhe neni 74, pika 4 e ligjit nr. 96/2016.

12. Në përfundim të hetimit gjyqësor, pasi trupi gjykues vlerësoi shkaqet e ngritura në ankim dhe pretendimet përfundimtare të Komisioneres Publike, si dhe analizoi provat që gjendeshin në fashikullin e hetimit administrativ të krijuar nga Komisioni dhe ato që u administruan gjatë procesit gjyqësor, të cilat iu nënshtuan debatit gjyqësor prej palëve, nën dritën e

⁸ Denoncimet e administruara në Kolegj, pas shpalljes së vendimit të Komisionit nr. 703, datë 28.09.2023, i cili konfirmoi në detyrë subjektin e rivlerësimit, znj. Suela Salvaci, janë përkatësisht: (1) Denoncimi i administruar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 02.10.2023, i sjellë nga E. L. (akte bashkëlidhur është vetëm një faqe nga një publikim i medias online CNA, çështje e evidentuar nga KPK-ja në rezultatet e hetimit administrativ, për të cilën nuk ka ankim nga Komisioneri Publik); (2) Denoncimi i administruar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 11.12.2023, i sjellë nga B. H. e B. V. (pa akte bashkëlidhur); (3) Denoncimi i administruar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 18.12.2023, i sjellë nga KPK-ja dhe përcjell denoncimin e B. H. e B. V. (pa akte bashkëlidhur); (4) Denoncimi i administruar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 26.12.2023, i sjellë nga T. Ç.j (pa akte bashkëlidhur); (5) Denoncimi i administruar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 15.01.2024, i sjellë nga K. B. (pa akte bashkëlidhur, çështje e trajtuar nga KPK-ja në rezultatet paraprake të hetimit administrativ, për të cilën nuk ka ankim nga Komisioneri Publik); (6) Denoncimi i administruar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 15.02.2024, i sjellë nga Gj. D. (me praktikë bashkëlidhur, denoncim i administruar pas depozitimit të ankimit); (7) Denoncimi i administruar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 09.04.2024, i sjellë nga E. L. (pa akte bashkëlidhur).

dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, vendosi lënien në fuqi të vendimit objekt ankimi. Arsyetimi mbi të cilin bazohet ky konkluzion shtjellohet në detaj në vijim duke ndjekur linjën e shkaqeve të ankimit.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit nga Kolegji

I. Lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë

13. Trupi gjykues fillimisht mori në analizë pretendimet e Komisioneres Publike, për sa i përket burimeve të krijimit të pasurive, për të cilat, sipas saj, subjekti nuk ka dhënë shpjegime bindëse dhe as ka provuar të kundërtën e barrës së provës, lidhur me: (i) shtrirjen e analizës financiare të personave të lidhur/tjerë të lidhur, prindërve, vetëm në masën e pasurive të dhuruara rast pas rasti. Komisionerja Publike pretendon se, sikundër ka rezultuar, të gjitha pasuritë e paluajtshme të prindërve, si dhe pjesërisht pasuritë e luajtshme, janë përfituar nga subjekti i rivlerësimit në formë dhurimi, heqje dorë apo dëshmi trashëgimie; (ii) referuar rastit konkret e rrethanave specifike të krijimit të pasurive, analiza dhe vlerësimi i pasurive do të duhet të bëhet në drejtim të garantimit të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, duke pasur në konsideratë parashikimet e nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, për sa kohë investimet e prindërve të subjektit, ndër vite, kanë kaluar në favor të subjektit të rivlerësimit, në një nga format e përmendura më sipër.

13.1. Nga sa më sipër, trupi gjykues vëren se Komisionerja Publike kërkon verifikimin e mundësisë së prindërve të subjektit për të financuar me burime të ligjshme të gjitha pasuritë që ata kanë krijuar, duke mos e kufizuar analizën vetëm në pasuritë që i kanë kaluar subjektit të rivlerësimit. Gjithashtu, Komisionerja Publike kërkon që kjo analizë të bëhet jo vetëm në drejtim të verifikimit të krijimit të pasurive me burime të ligjshme, por në kushtet që ajo [Komisionerja] referon disa dispozita të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, presumohet se kërkimi përfshin edhe përjashtimin e mundësisë që pasuri të caktuara të prindërve të përbëjnë pasuri të fshehur të subjektit, në kushtet që pasuritë e prindërve të subjektit konstatohet se përgjithësisht shkojnë në favor të saj dhe jo të vëllait.

13.2. Lidhur me burimet e krijimit të pasurive të subjektit të rivlerësimit që janë financuar nga të ardhurat nga shitblerja dhe qiradhënia e pasurive të prindërve së saj, Komisioni ka konkluduar se prindërit e subjektit kanë pasur mundësi të investojnë në pasuritë e dhuruara subjektit, pra, nuk ka fshehje pasurie prej saj. Po ashtu, Komisioni ka konstatuar se nëna e subjektit ka përfituar shumat e deklaruara nga qiradhënia e ndërtesës [ish-Ambasada Franceze], sipas pjesës së saj takuese, në vitet 1995-2005, të cilat kalojnë edhe testin e ligjshmërisë, pasi detyrimin për pagimin e tatimit në burim e ka qiramarrësi [Ambasada Franceze], si person juridik.

13.3. Në funksion të analizimit të këtyre pretendimeve të Komisioneres Publike, trupi gjykues konstaton se prindërit e subjektit janë konsideruar si *persona të tjerë të lidhur*, sipas parashikimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, gjatë hetimit administrativ në Komision, në analizën financiare të kryer për pasuritë⁹, të cilat më pas ata ia kanë kaluar me

⁹ Këto pasuri janë përkatësisht: (i) Apartament me sip. 121,36 m², rruga “{***}”, Tiranë: Në deklaratën vetting, subjekti ka deklaruar se porositen dhe likuidimin e çmimit të apartamentit nga nëna e saj, sipas kontratës së porosisë datë 10.03.2005, në vlerën 38.800 USD, e finalizuar nga subjekti me kontratën e shitblerjes datë 20.11.2013 dhe deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.11.2013, nëpërmjet të cilës nëna ka hequr dorë nga pronësia e apartamentit dhe ia ka dhuruar atë subjektit; (ii) Apartament me sipërfaqe 84 m²,

dhurim subjektit të rivlerësimit. Nisur nga situata faktike¹⁰, në të cilën duket se prindërit i kanë dhuruar subjektit të rivlerësimit pothuajse të gjitha pasuritë që ajo deklaron në deklaratën *vetting*, Komisionerja Publike ka kërkuar me ankimin që analiza për prindërit e subjektit, duhet të bëhet jo vetëm duke u limituar në verifikimin e mundësive të tyre për të krijuar me burime të ligjshme pasuritë të cilat prindërit ia kanë dhuruar subjektit të rivlerësimit, por edhe për të gjitha pasuritë e tjera, të cilat në një mënyrë apo në një tjetër shkojnë te subjekti i rivlerësimit.

13.4. Së pari, trupi gjykues i Kolegjit vëren se kryerja e analizës financiare të prindërve të subjektit në tërësi, pa u kufizuar vetëm në pasuritë që i kanë kaluar asaj nëpërmjet dhurimit, heqjes dorë nga të drejtat pasurore apo nga trashëgimia, sikurse kërkon Komisionerja Publike, kapërcen kufijtë e përcaktuar nga neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 dhe jurisprudenca e Kolegjit¹¹. Në kushtet kur prindërit e subjektit të rivlerësimit nuk janë kategorizuar në asnjë fazë të procesit të rivlerësimit në Komision si persona të lidhur me subjektin, nuk rezultojnë që të jenë pjesë e certifikatës familjare të saj dhe, mbi të gjitha, kur për pasuritë e prindërve të subjektit nuk është hetuar dhe as i janë kërkuar subjektit shpjegime për dyshime se mund të përbëjnë pasuri të fshehura të saj, analiza përtej kufijve të kontributit pasuror të prindërve në favor të subjektit, sikurse është arsyetuar në jurisprudencën e Kolegjit në mënyrë konsistente, analiza financiare për të gjitha pasuritë e krijuara nga prindërit do të kapërcente kufijtë e kontrollit të pasurive që i janë dhuruar subjektit të rivlerësimit. Një analizë e kryer në këtë shtrirje, në rrethanat konkrete, do të ishte disproporcionale dhe do të ekspozonte procesin e rivlerësimit ndaj pyetjeve serioze për përmbushjen e garancive kushtetuese që subjektet gëzojnë për një proces të rregullt ligjor.

*në Golem: Në deklaratën vetting, subjekti ka deklaruar se apartamenti është porositur nga babai, sipas deklaratës noteriale datë 08.02.2005 dhe kontratës së porosisë datë 08.10.2010, pasuri e paregjistruar, porositur kundrejt çmimit 72.000 euro. Deklaruar në vitin 2012, kontrata e porosisë, vlera, pjesa takuese 100%. Mungon burimi; (iii) Banesë dhe truall në rrugën “{***}”: Në deklaratën vetting, subjekti ka deklaruar si adresë banimi, në pronësi të babait, e formalizuar me deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.10.2016. Referuar kësaj deklarate, babai i subjektit, ndër të tjera, deklaroi se vajza së bashku me familjen e saj jetojnë prej vitit 1998 në banesën e tij, pashpërblim. Kjo pasuri me anë të kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.04.2017, i dhurohet subjektit të rivlerësimit nga prindërit e saj; (iv) Gjendje cash në shumën 10.000 euro, me burim nga shitja e një pasurie të paluajtshme: Në deklaratën vetting, subjekti ka deklaruar se këto likuiditete kanë si burim të ardhurat nga shitja e një pasurie të paluajtshme me kontratën e premtim shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.08.2012, të lidhur ndërmjet shitësve trashëgimtarë të z. K. K., përfshirë edhe nënën e saj dhe blerësit shoqëria “{***}” ShPK; (v) Depozitat dhe llogaritë dyemërore bashkëmbajtëse të subjektit me prindërit: Në deklaratën vetting, subjekti ka deklaruar se llogaria bankare është hapur nga prindërit e saj në datën 04.02.2005, pranë NBG-së, me gjendje në shumën 52.534 USD dhe në datën 17.12.2012 subjekti është bërë bashkëmbajtëse në këtë llogari dhe nuk ka kontribuar në hapjen e saj. Gjendja e llogarisë më 17.12.2012 ka qenë në shumën 63.504 USD. Në deklaratën për vitin 2004, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar depozitën në shumën 52.000 USD, pa pjesë takuese të saj, në emër të të atit; në deklaratën për vitin 2012, në rubrikën “Të dhëna konfidenciale”, subjekti ka deklaruar: Mbajtëse e tretë llogarie në NBG dhe llogari mbajtësit, prindërit e saj; (vi) Llogaritë e vajzave të subjektit: Në deklaratën vetting, subjekti ka deklaruar gjendjen e llogarive në emër të vajzave, përkatësisht në vlerat 11.652 USD pranë Intesa Sanpaolo Bank dhe në shumën 6.462 USD, në Credins Bank. Subjekti deklaroi se llogaritë bankare janë hapur në vitet 2004 dhe 2011 përkatësisht nga e ëma, e cila ka kryer edhe shtesat ndër vite. Si burim krijimi janë deklaruar të ardhurat e familjes.*

¹⁰ Parashtruar si vijon: (i) të gjitha pasuritë që kanë krijuar dhe disponuar prindërit e subjektit kanë shkuar në favor të saj; (ii) për shkak të dhurimeve periodike të shumave monetare që prindërit i bëjnë subjektit apo fëmijëve të saj, analiza financiare e prindërve është bërë gati e përvitshme; (iii) subjekti ka përfutur prej prindërve pasuri të paluajtshme edhe pas depozitimit të deklaratës *vetting*, dhe likuiditete, për shkak të trashëgimisë ligjore, pasi babai i saj ka ndërruar jetë.

¹¹ Shih, ndër të tjerë, vendimin e Kolegjit (JR) nr. 15/2019, që i përket subjektit të rivlerësimit Dritan Rreshka, vendimin që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi (JR) nr. 22/2022 dhe vendimin e Kolegjit (JR) nr. 2/2023, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Elona Toro.

13.5. Në këtë vlerësim, trupi gjykues i Kolegjit sjell në vëmendje edhe faktin që pasuritë dhe të ardhurat mbi bazën e të cilave subjekti ka përfituar pasuri të paluajtshme e të luajtshme, datojnë jo vetëm shumë kohë përpara se subjekti të merrte funksionin e prokurores, por edhe kanë ardhur në disponim të prindërve të saj nëpërmjet trashëgimisë ligjore, si një nga format e fitimit të pronësisë, si dhe nëpërmjet procesit të njohjes e të kthimit të pronave ish-pronarëve. Konkretisht, shtëpia ku kanë banuar prindërit e subjektit është krijuar që në vitin 1998, ndërsa për veprimet e kryera në funksion të krijimit të pasurive nga nëna si trashëgimtare e ish-pronarëve, Komisioni nuk ka hetuar dhe as ka indicie për veprime të kryera nga subjekti në funksion të përfitimeve në tërësi apo përfitimeve të paligjshme në veçanti. *Së fundmi*, aktmarrëveshja e hartuar nga nëna e subjektit në mars të vitit 2003, me objekt tokën në Jalë (Vuno), daton në një kohë kur subjekti nuk ishte emëruar ende prokurore¹².

13.6. Ndonëse në ankimin e paraqitur nga Komisionerja Publike, është referuar edhe pika 5 e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, për sa kohë ky kërkim është i përgjithshëm, pasi i mungon referenca konkrete apo indirekte gjuhësore, se për cilin aspekt dhe për cilat arsye duhet të hetohet për pasuri të fshehura të subjektit, ky pretendim mbeti i pashoqëruar me veprime e kërkesa procedurale apo kontestim, si në ankim, ashtu edhe në parashtrimet dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor. Ky potencim, përpos referencës kalimthi, në një pikë të nenit D të Aneksit të Kushtetutës mbeti i paartikulluar, i pashtjelluar, i pakonkretizuar me pasuri, me kohë, apo veprime të tjera, dinamika e të cilëve do të mundësonte, qoftë vlerësimin e trupit gjykues, ashtu edhe mbrojtjen e subjektit, në funksion të ushtrimit të të drejtave të saj kushtetuese e konventore për gjykim kontradiktor e për t'u mbrojtur. Si rrjedhojë e këtij konstatimi, trupi gjykues i Kolegjit çmon se ky pretendim i vetëm e kalimtar për kontrollin e pasurisë së prindërve të subjektit në tërësi e bën të pabalancuar kërkesën për të kapërcyer verifikimin e mundësive të tyre financiare përtej kufijve të përcaktuar nga pika 4 e nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, për personat *e tjerë të lidhur*.

13.7. Në përfundim, bazuar në sa analizuar më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi se kërkimi i Komisioneres Publike, për të shtrirë analizën financiare ndaj prindërve të subjektit për të verifikuar mundësinë e tyre për të krijuar me burime të ligjshme *të gjitha* pasuritë që ata kanë krijuar e disponojnë, nuk është një pretendim i drejtë dhe as i bazuar ligjërisht. Për rrjedhojë, analiza financiare e prindërve të subjektit në Kolegj u krye vetëm për ato pasuri të cilat ata i kanë dhuruar/kaluar subjektit të rivlerësimit, deri në momentin e plotësimit të deklaratës *vetting*.

14. Në vijim, trupi gjykues mori në analizë pretendimet e Komisioneres Publike, sipas së cilës është e padrejtë dhe e pa mbështetur në prova përfshirja në mesin e burimeve të ligjshme të prindërve të subjektit e të ardhurave të nënës nga pjesa takuese e trashëgimisë së tezes së saj. Sipas Komisioneres, subjekti i rivlerësimit: (i) nuk rezulton ta ketë deklaruar këtë burim asnjëherë; (ii) nuk provoi posedimin/kalimin e këtyre të ardhurave nga trashëgimtarët e tjerë të nëna e saj, duke mbetur kjo e ardhur në nivel deklarativ dhe jo në harmoni me provat e administruara gjatë procesit.

14.1. Gjatë hetimit administrativ në Komision, si dhe në parashtrimet e paraqitura gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes në Kolegj, subjekti ka pretenduar se të ardhurat e pjesës

¹² Subjekti është emëruar prokurore më 11.11.2003, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës.

takuese të tezes së nënës së saj, e cila ka jetuar në Francë dhe nuk ka shfaqur interes për pasuritë e trashëguara në Shqipëri, janë shpërndarë të trashëgimtarët e tjerë të familjes K., dhe se pjesa takuese që ka përfituar nëna e saj nga kjo shpërndarje është në shumën rreth 3.500.000 lekë. Për sa më sipër, për të ardhurat e nënës nga pjesa takuese e tezes së saj nga qiradhënia e shitja e pasurive, Komisioni ka konkluduar se kalimi i të ardhurave të tezes së nënës nuk provohet dhe, në mesin e të ardhurave, ka përfshirë të ardhurat sipas pretendimit të subjektit. Komisioni ka konstatuar se teza e nënës nuk rezulton të ketë nënshkruar në asnjë akt për përfitime nga shitja e pasurive trashëgimore. Në mbërritjen në këtë konkluzion, Komisioni ka mbajtur në konsideratë edhe deklaratën noteriale të vitit 2001, ku trashëgimtarët e fisit [K.] marrin përsipër të zgjidhin çdo pretendim që mund të lindë nga teza për pasurinë.

14.2. Për të provuar sa më sipër për masën dhe shpërndarjen e të ardhurave që i takonin tezes së nënës së saj¹³, nga shitja dhe qiradhënia e pasurive të paluajtshme, në Komision dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes në Kolegj, subjekti i rivlerësimit ka identifikuar përkatësisht aktet:

(i) kontratë shitje e pasurisë së paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.07.2001, me palë blerëse shoqërinë “{***}” ShPK, kundrejt çmimit 320.000 USD, në të cilën rezulton se në listën e përfituesve bashkëngjitur saj, për tezen E. Dh. nuk ka firmosur asnjë përfaqësues për tërheqjen e shumës monetare, që rrjedhimisht tregon se për tezen nuk është bërë shpërndarje e të ardhurave nga shitja e pasurisë së paluajtshme;

(ii) deklaratë noteriale nr. {***}, datë 10.05.2001, nëpërmjet të cilës deklaruesit: Sh. M. K., M. K., E. G. (S.), S. G. dhe K. G., garantojnë blerësin se çdo pretendim nga motra dhe teza jonë E. Dh. (K.) dhe trashëgimtarët e saj, që jetojnë në Francë, do ta zgjidhin ne, duke mënjanuar në të gjitha rastet e mundshme blerësin;

(iii) kontratë shitblerje e pasurisë së paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.09.2002, kundrejt çmimit 550.000 USD, në familjen K., për tezen E. K., në shumën 56.567,5 USD nuk është firmosur e, rrjedhimisht, kjo shumë monetare është shpërndarë ndërmjet anëtarëve të tjerë të familjes K.;

(iv) kontratë shitblerje e pasurisë së paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.01.2010, nuk rezulton se trashëgimtarët e tezes E. K. kanë firmosur dhe kanë përfituar të ardhura.

14.3. Në aktet e fashikullit të Komisionit gjendet e administruar përkatësisht shkresa “Kthim Përgjigje”¹⁴, e përfaqësueses me prokurë e trashëgimtareve të tezes, e cila shprehet se e ndjera dhe trashëgimtarët e saj nuk kanë përfituar të ardhura nga kontratat e qirasë të ish-godinës së Rezidencës së Ambasadës Franceze, si dhe të ardhura nga kontratat e shitblerjes në vitet 2001, 2002 dhe 2010. Në mbështetje të këtij qëndrimit, përfaqësuesja me prokurë i ka përcjellë Komisionit prokurën e posaçme datë 28.12.2019, me anë të së cilës trashëgimtarët e të ndjerës kanë autorizuar atë vetë [avokaten M. B.] që të kërkojë nga çdo organ publik dhe jopublik të tërheqë dokumente të ndryshme që lidhen me pronësitë, të kërkojë shumat e përfituara nga qiratë dhe nga çdo kontratë tjetër të nënshkruar në emër të trashëgimtareve nga përfaqësuesi i tyre¹⁵. Po ashtu, në kthimin e përgjigjes drejtuar Komisionit, avokatja ka paraqitur edhe “Certifikatën e Trashëgimisë”, të lëshuar në datën 30

¹³ Znj. E. Dh. (K.).

¹⁴ E administruar në Komision me nr. {***} prot., datë 06.01.2023, e avokates së trashëgimtarëve të tezes së nënës së subjektit, znj. M. B..

¹⁵ Z. K. G..

shtator 2005, nëpërmjet të cilës evidentohet se tezja e nënës ka ndërruar jetë në datën 04.12.2000, në Francë [Pont de Cheruy].

14.4. Bazuar në aktet e paraqitura më sipër, subjekti ka pretenduar në Komision dhe në Kolegj, se as tezja e nënës dhe as trashëgimtarët e saj nuk provohet të kenë përfituar të ardhura nga kontratat e shitblerjes, si dhe nga kontratat e qirasë së pasurive të paluajtshme, të paktën deri në vitin 2010, sikurse konfirmohet dhe prej përfaqësueses së trashëgimtarëve. Subjekti ka shpjeguar se të ardhurat e pjesës takuese të tezes janë shpërndarë midis anëtarëve të tjerë të kësaj familjeje. Njësoj kanë vepruar dhe përfaqësues të tjerë të bashkëpronësisë sipas trunjeve familjare. Subjekti ka shpjeguar se nëse do të shikohen transaksionet bankare të kryera nga *vëllai i nënës së subjektit*, në disa raste përfaqësues i familjes, do të konstatohej qartë që asnjëherë ai nuk ka transferuar para në emër të tezes së tij dhe të nënës së subjektit, ashtu siç ka vepruar me trashëgimtarë të tjerë që jetojnë jashtë Shqipërisë.

14.5. Gjatë hetimit administrativ në Komision, për të provuar pagesën e tatimit në burim për të ardhurat e përfituara nga shitja e pasurive të paluajtshme, subjekti ka depozituar shkresën datë 05.06.2023, të nënshkruar elektronikisht nga AShK Drejtoria Vendore Tirana Jug dhe dokumentacionin ku provohet pagesa e tatimit për tri kontratat e shitjes së pasurive në vitet 2001, 2002 dhe 2010¹⁶. Bazuar në shpjegimet e mësipërme, si dhe në aktet e paraqitura nga subjekti, Komisioni ka konkluduar të përfshijë në analizën e financiare të nënës së subjektit shumën prej 3.400.000 lekësh, si pjesë e të ardhurave të përfituara nga nëna e subjektit, nga tërësia e të ardhurave që i takonte tezes së saj nga trashëgimia. Me këtë qëndrim, Komisioni ka pranuar që pjesa takuese e kësaj trashëgimtareje, e cila kishte jetuar dhe ndërruar jetë në Francë, është ndarë në mënyrë të barabartë te pesë (5) trashëgimtarët e tjerë, përfshirë nënën e subjektit.

14.6. Në referim të pretendimit të Komisioneres Publike, trupi gjykues i Kolegjit, çmon se, për këtë shkak ankimi, çështjet objekt analize kanë të bëjnë me: (i) nevojën për deklaram nga subjekti ndër vite apo në deklaratën *vetting* të këtyre të ardhurave nga subjekti, si një prej burimeve të krijimit të pasurive; (ii) nëse provohet posedimi/kalimi i të ardhurave të tezes te nëna e saj, element me rëndësi për të provuar përfitimin e kësaj të ardhure sikurse pretendohet.

14.7. Për rrjedhojë, lidhur me pyetjen/çështjen e parë të shtruar, trupi gjykues konstatoi se në deklaratën *vetting*, për pasuritë që ajo ka pasur në pronësi, subjekti i rivlerësimit ka identifikuar si burim krijimi të ardhurat e familjes nga kontratat e qirave, nga shitja e pasurive të paluajtshme, etj. Po në deklaratën *vetting*, në rubrikën dedikuar të dhënave konfidenciale, subjekti i rivlerësimit ka identifikuar/përshkruar¹⁷ si burim financimi për pasuritë që disponon të ardhurat e gjeneruara nga shitja dhe qiradhënia e pasurive të trashëguara nga nëna e saj nga trashëgimia në fjalë dhe ka identifikuar edhe vendimet e gjykatës për çeljen e dëshmisë së trashëgimisë. Për sa përshkruar më sipër, trupi gjykues

¹⁶ Me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.07.2001; nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.09.2002 dhe nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.01.2010.

¹⁷ Në aktet në fashikull gjendet i administruar me përgjigjet e pyetësorit nr. 1, vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt "Lëshimi i dëshmisë së trashëgimisë ligjore" të Dr. S. S., me nr. {***} akti e nr. {***} vendimi, datë 02.07.1996. Si trashëgimtare ligjore e tij figuron ,ndër të tjerë, edhe znj. E. Dh. (K.) me 1/24 pjesë takuese dhe E. S. me 1/72 pjesë takuese. Në këtë vendim, ndër të tjera, pasqyrohet se për Dr. S. S. është lëshuar dëshmia e trashëgimisë me nr. {***}, datë 01.11.1993, nga zyra e noterisë Tiranë. Ky akt nuk gjendet i administruar në fashikull.

vëren se mënyra e deklarimit të subjektit në deklaratën *vetting*, është e pa detajuar dhe le vend për kujdes të shtuar nga ana e saj. Ky konstatim paraqet rëndësi, pasi pasuritë në analizë që ka përfituar nëna e saj janë të konsiderueshme, sikurse janë të konsiderueshme edhe përfitimet që ka gjeneruar subjekti prej tyre. Këto aspekte e bëjnë me rëndësi kujdesin dhe rigorozitetin në deklarim, së paku në deklaratën *vetting*. Po ashtu, parë në aspektin e kujdesit të veçantë që do të duhet të kishte treguar subjekti, pasuritë në vlera të konsiderueshme që nëna e saj deklarohet të ketë marrë nga shpërndarja e pjesës takuese të pasurisë së tezes së saj, në kushtet konkrete, është një e dhënë/element që nuk mund të mos kishte rëndësi e të gjente pasqyrim në deklaratën *vetting*. Faktin që pjesa takuese e tezes së nënës është ndarë mes trashëgimtarëve me banim në Shqipëri apo se ajo/trashëgimtarët e saj nuk kishte shfaqur asnjë interes për marrjen e pronave, subjekti e ka shpjeguar për herë të parë me përgjigjet e dhëna për pyetësonin nr. 3 dhe më pas e ka mbështetur edhe në shpjegimet për rezultatet paraprake të hetimit administrativ.

14.8. Në këto kushte, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se si burim financimi për pasuritë që ka disponuar nëna e subjektit kanë shërbyer *pjesërisht* edhe të ardhurat e gjeneruara nga pasuritë që kanë qenë në pronësi të trashëgimlënësit, i cili, sipas aktit të trashëgimisë ligjore, është trashëguar nga shumë trashëgimtarë, përfshirë këtu edhe nënën e subjektit. Në këtë kuptim, duke konsideruar atë që deklaroi/pretendoi subjekti, rezulton se nëse të ardhurat e tezes kanë qenë burim për pasuritë e krijuara nga nëna e saj, kjo është një pasuri që nuk i vjen nënës së saj nga trashëgimia e S. S., por nga përfitimi pa shkak i pjesës takuese së tezes.

14.9. Për sa i përket çështjes/pyetjes së dytë të ngritur mbi këto të ardhura, përpos sa analizuar më sipër, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit, edhe në Kolegj, sikurse në Komision, ka pretenduar se shuma 3.400.000 lekë¹⁸, që i ka shkuar nënës së saj, përfaqëson një pjesë të të ardhurave të gjeneruara në tërësi nga pasuritë e tezes, si shumatore nga qiradhëniet dhe shitjet e pasurive të paluajtshme të siguruara nga trashëgimia ligjore, e ndarë në mënyrë të barabartë të (5) pesë pjesëtarët e familjes në fjalë, si pasojë e kontratave të shitjeve të pasurive të paluajtshme të trashëgimlënësit, përkatësisht:

a) Kontrata noteriale datë 19.07.2001, me palë blerëse shoqërinë “{***}” ShPK, për çmimin 320.000 USD, në të cilën si një nga bashkëpronarët e kësaj pasurie është edhe teza e nënës, përfaqësuar me prokurë [nga M. K.]. Në këtë kontratë, përcaktohet se çmimi 320.000 euro do të bëhet me dy derdhje në llogaritë bankare të dy shitësve, përfaqësues me prokurë. Nga aktet e përcjella në Komision nga subjekti, rezulton se në vitin 2001 është hartuar deklarata noteriale, datë 10.05.2001, nëpërmjet së cilës fisi/familja K. e përbërë nga pesë anëtarë, përfshirë nënën e subjektit, kanë garantuar blerësin se për çdo pretendim në të ardhmen nga E. Dh. (K.) dhe trashëgimtarët e saj që jetojnë në Francë, ata do ta zgjidhin duke e mënjeluar blerësin në të gjitha rastet.

b) Kontrata e shitjes së pasurisë truall me sip. 2468 m², datë 20.09.2002, me palë blerëse një individ tjetër për çmimin 550 USD/për metër katror, si një nga bashkëpronarët e kësaj pasurie, si palë shitëse është identifikuar teza e nënës së subjektit, pa specifikuar përfaqësimin e saj me prokurë nga dikush. Në këtë kontratë, ndër të tjera, përcaktohet se: “Për bashkëpronarët që jetojnë jashtë shtetit (tre familje dhe z. A. P.) në Bankën Credins Sh.A do të hapet numri i llogarisë në emër të K. G.”.

¹⁸ Pjesa takuese e nënës në shumën 3.404.664 lekë, sipas Komisionit përbëhet nga 1.523.565 lekë të ardhura nga qiradhënia e ish-Godinës së Ambasadës Franceze dhe nga 1.881.099 lekë nga shitja e pasurive.

Kjo kontratë, në nenin që përcakton *bashkëpronarët me pjesëmarrje* në ndërtim, përcakton se atyre blerësi u ka garantuar brenda kufijve të pjesës takuese *pjesëmarrjen në masën 33%*. Në tabelën e pjesës takuese në metra katrorë dhe vlerën respektive, tezes së nënës i takon sipërfaqja 102,85 m², ekvivalenti i 56.567 USD. Në kontratë nuk ka nënshkrim që provon marrjen e kësaj shume prej saj apo trashëgimtarëve e të afërmeve të saj.

c) Ndërsa në kontratën e shitjes së truallit me sip. 670 m² + objekt 181 m² 1 kat të datës 14.01.2010, me palë blerëse katër (4) individë¹⁹ për çmimin në total 502.500 euro, si palë shitëse në tërësinë e bashkëpronarëve të kësaj pasurie, nuk figuron tezja e nënës, por janë përfshirë nëntë (9) trashëgimtarët e saj me mbiemër Dh., për të cilët kontrata përcakton se janë përfaqësuar me prokurat respektive nga K. G..

14.10. Nga aktet e mësipërme, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se: (i) në vendimin gjyqësor me objekt lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore²⁰, ndër të tjerë, tezja e nënës së subjektit figuron zotëruese me 1/24 pjesë takuese dhe nëna e subjektit me 1/72 pjesë takuese; (ii) në kontratat e shitjes së pasurive të paluajtshme, si dhe ato të qiradhënies së pronave të trashëguara, sipas rastit, tezja e nënës së subjektit figuron në cilësinë e shitëses, në kontratën e shitjes së pasurisë në vitin 2001, e përfaqësuar me prokurë nga i vëllai [z. M. K.], ndërsa në kontratën e shitjes së vitit 2010, ajo nuk është pjesë e bashkëpronarëve palë shitëse, pasi rezulton të jetë zëvendësuar me nëntë (9) trashëgimtarët e saj, të përfaqësuar nga i nipi [z. K. G.]; (iii) përmbajtja e kontratës së shitjes, realizuar nga bashkëpronarët më datë 20.09.2002, me palën blerëse për sipërfaqen 2468 m², evidenton se për shkak se trashëgimtarja/tezja e nënës së subjektit nuk ka marrë pjesën takuese të çmimit të shitjes së kësaj pasurie në shumën 56.567 USD, së bashku me disa trashëgimtarë të tjerë, ajo është bashkëpronare e truallit në pjesë të pandara (objekt i kontratës së shitjes) në masën 108,2 m².

14.11. Përcaktimet kontraktuale si më sipër, ndryshe nga sa ka pranuar Komisioni, në mënyrë të qartë kanë përjashtuar përfitimin e shumës 56.567 USD, nga ndonjë prej bashkëpronarëve të tjerë, që mund të pretendohen se kanë përfaqësuar tezen e nënës së subjektit. Për rrjedhojë dhe në linjë me të dhënat që ofron kontrata e shitjes së pasurisë në vitin 2001 dhe kontrata e shitjes së pasurisë në vitin 2010, së shumti mund të pretendohet se shumata e siguruar nga këto shitje, që i takojnë tezes së nënës së subjektit/trashëgimtarëve ligjorë të saj, mund të jenë përfituar nga përfaqësuesit e saj me prokurë, në kontratat e viteve 2001 dhe 2010²¹.

14.12. Në datën 10.05.2001, familja K. e përbërë nga pesë (5) anëtarë, përfshirë edhe nënën e subjektit, ka hartuar një deklaratë noteriale nëpërmjet të cilës *ka garantuar* blerësin se çdo pretendim në të ardhmen nga trashëgimtarja tjetër [tezja e nënës] dhe trashëgimtarët e saj që jetojnë në Francë, do të zgjidhej duke e mënjeluar blerësin në të gjitha rastet. Kjo deklaratë daton *përpara* kontratës noteriale të shitjes së pasurisë truall me sip. 1102 m² dhe objekt 1 kat me palën blerëse, shoqërisë “{***} [më datë 19.07.2001]. Në këtë kontratë të dytë, tezja e nënës përfaqësohet me prokurë nga z. M. K. [vëllai i saj]. Në këto rrethana, trupi gjykues çmon se, ndryshe nga sa ka arsyetuar Komisioni, këto akte nuk provojnë ndarjen e pjesës takuese të tezes nga të gjithë nënshkruesit e kësaj deklarate, pjesë e të cilëve është edhe nëna e subjektit të rivlerësimit. Parë në këtë kontekst, deklarata noteriale duket se është bërë për

¹⁹ N. U., P. U., A. Sh. e E. Sh..

²⁰ Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me nr. {***}, datë 02.07.1996.

²¹ Përkatësisht, i vëllai z. M. K. dhe nipi z. K. G., i cili në kontratën e vitit 2010 evidentohet si përfaqësuesi me prokurë i trashëgimtarëve të E. Dh. (K.).

të mos dështuar lidhja e kontratës së shitjes së pasurisë e datës 19.07.2001, me shoqërinë “{***}” ShPK.

14.13. Në vijim, trupi gjykues u ndal në analizimin e kontratave të qiradhënies të pasurive të trashëguara nga trashëgimlënësi S. S., ndër vite. Nga të dhënat e administruara nga hetimi administrativ, në kontratat e dhënies me qira të objektit ish-Rezidenca e Ambasadës Franceze, rezulton se duke nisur nga viti 1995 ato janë nënshkruar nga përfaqësuesi i trashëgimtarëve, bashkëpronar z. K. G. apo z. M. K.. Për rrjedhojë, trupi gjykues konstaton se edhe për të ardhurat nga qiradhënia nuk provohet ndarja e pjesës takuese të tezes së nënës së subjektit, në mënyrë të barabartë të pjesëtarët e tjerë të familjes K., pjesë e të cilëve është edhe nëna e subjektit.

14.14. Bazuar në sa evidentuar më sipër, trupi gjykues i Kolegjit e gjeti të bazuar pretendimin e Komisioneres Publike që në analizën e të ardhurave me burime të ligjshme të nënës së subjektit të mos përfshihen pjesa e të ardhurave të cilat ajo deklaroi se përbëjnë pjesën takuese të *papërfitur* nga teza e nënës e trashëgimtarët e saj, të cilët kanë jetuar jashtë Shqipërisë ndër vite. Sikurse ka potencuar edhe Komisionerja Publike, subjekti i rivlerësimit nuk rezulton t’i ketë specifikuar këto të ardhura që përbëjnë përfitim përtej pjesës takuese të nënës nga trashëgimia, në mesin e burimeve të përdorura për krijimin e pasurive, qoftë në deklaratën *vetting*, në deklaratimet periodike vjetore apo edhe në procesverbalin e mbajtur pranë ILDKPKI-së në vitin 2016. Përpos faktit që ky zë të ardhurash – *përfitim nga pjesa takuese e një trashëgimtareje tjetër* – do të duhet të ishte deklaruar në mënyrë konkrete për shkak të rrethanave të pretenduara, nga një lexim harmonik i akteve në fashikull dhe provave, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk provoi posedimin/kalimin e tyre nga trashëgimtarët e tjerë të nëna e saj.

14.15. Në përfundim, në analizë të kësaj situate faktike, trupi gjykues konkludoi se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se nga shitja dhe qiradhënia e pasurive të paluajtshme nëna e saj ka përfitur jo vetëm pjesën e saj, por edhe pjesë nga pjesa takuese e tezes së nënës, është një pretendim në nivel deklarativ. Trupi gjykues vlerësoi të kryejë kontrollin e burimeve të ligjshme të personit tjetër të lidhur/nënës së subjektit pa përfshirë përfitimet nga pjesa takuese e asaj trashëgimtareje.

- 15.** Në vijim, trupi gjykues vijoi analizën lidhur me pretendimin e Komisioneres Publike për të mos përfshirë në mesin e të ardhurave të ligjshme, që kanë shërbyer për krijimin e pasurive nga prindërit e subjektit, të ardhurat nga aktmarrëveshja e datës 29.4.2003, mes nënës së subjektit dhe një individi [z. A. Xh.], për tokën në Jalë (Vuno). Sipas Komisioneres Publike: (a) shuma prej 15.500.000 lekësh, e referuar në këtë akt, nuk është deklaruar asnjëherë si burim për krijimin e pasurive, në deklaratën *vetting*, në deklaratat periodike vjetore dhe as në procesverbalin në ILDKPKI në vitin 2016. Mungesa e dijenisë mbi këtë akt, e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit, bie në kundërshtim me deklarin e saj mbi burimet e depozitave, të krijuara në vitin 2003 nga prindërit; (b) gjithashtu, kjo aktmarrëveshje është nënshkruar në kushtet e mungesës së titullit të pronësisë nga nëna e subjektit; dhe (c) nuk provohet arkëtimi i shumës dhe marrëveshja nuk rezulton të jetë pasqyruar në ndonjë nga aktmarrëveshjet e mëvonshme, nënshkruar për të njëjtën pronë me shoqërinë “{***}” ShPK.

15.1. Komisioni ka konkluduar se bazuar mbi shkresën e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, sjellë nga subjekti në përgjigje të rezultateve të hetimit, tatimi do të paguhej vetëm

përpara kalimit të së drejtës së pasurisë së paluajtshme dhe është parakusht për regjistrimin e pasurisë nga institucioni përkatës. Komisioni ka konkluduar se subjekti ka paraqitur shpjegime dhe prova të mjaftueshme për ligjshmërinë e të ardhurave të prindërve në funksion të blerjes së apartamentit në Tiranë, në shumën 38.800 USD, që i kanë dhuruar subjektit në vitin 2013 dhe mundësinë e tyre financiare për blerjen e apartamentit në vitin 2005. Komisioni është shprehur edhe që ky konkluzion është analizuar në raport me parashikimin në nenin D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, i cili si parakusht për përgjegjësinë disiplinore për efekt të procesit të rivlerësimit kërkon që pasaktësitë, si premisë për shkarkim, të jenë kryer me qëllim fshehjen e pasurisë apo deklarimin e pasaktë të të dhënave.

15.2. Në analizën e akteve në fashikull, nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, trupi gjykues i Kolegjit e gjeti të pabazuar pretendimin e Komisioneres Publike për të mos përfshirë në mesin e burimeve të ligjshme të prindërve të subjektit shumën e përfituar nga aktmarrëveshja e lidhur nga nëna e subjektit në datën 29.04.2003, me një ndërtues për një pronë të ndodhur në bregdet, me objekt zhvillimin. Aktmarrëveshja në fjalë, nga e cila deklarohet një përfitim i konsiderueshëm [15.5 milionë lekë], rezultoi të jetë formalizuar në një akt të shkruar, në të njëjtën ditë, përpara noterit. Nëpërmjet kësaj marrëveshjeje, nëna e subjektit ka rënë dakord për zhvillimin e pjesës së pronës së saj në Jalë/Vuno, të njohur ligjërisht me vendimet respektive të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave. Me fjalë të tjera, palët kanë kryer veprime të cilat janë në përputhje me ligjin, për to nuk rezultoi të ketë pasur kontestim ligjor, sikurse edhe pasqyrohen përpjekje logjike të ndërmarra prej porositëses [nënës së subjektit], për të mundësuar krijim përfitimesh nga prona e fituar me ligj.

15.3. Në këto kushte, trupi gjykues e konsideroi të drejtë qëndrimin e Komisionit në vendim për të përfshirë në analizën financiare të prindërve të subjektit shumën prej 15.500.000 lekësh, me burim nga aktmarrëveshja e datës 29.04.2003, e cila, në kuptim të përcaktimeve të nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016, përmbush kërkesën për t'u konsideruar e ardhur e ligjshme. Arsyetimi mbi të cilin bazohet ky konkluzion shtjellohet në vijim.

15.4. *Së pari*, trupi gjykues i Kolegjit analizoi deklaratimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënat sa vijon: (i) në deklaratën *vetting*, për pasuritë e *paluajtshme* [apartament në Rrugën e {***}], në Tiranë dhe apartament në Golem] dhe pasuritë e *luajtshme* [depozitë dyemërore në BKT, në emër të subjektit dhe nënës, në vlerën 65.000 USD, depozitë në Intesa Sanpaolo Bank dhe në Credins Bank, në emër të vajzave të subjektit, përkatësisht në shumat 11.652 USD dhe 6.462 USD, për të cilat subjekti ka deklaruar si burim krijimi të ardhura të familjes nga kontratat e qirave, shitja e pasurive të paluajtshme, etj. Referohu dokumentacionit bashkëlidhur deklaratës lidhur me burimin e krijimit; (ii) po në deklaratën *vetting*, në rubrikën dedikuar të dhënave konfidenciale, për sa i përket burimeve të krijimit, subjekti ka individualizuar të gjitha kontratat e shitjes dhe të qiradhënies së pasurive të paluajtshme të përfituara nga trashëgimia [e nënës nga S. S.], por nuk ka përmendur si burim të ardhurash ato të siguruara nga nëna e saj nëpërmjet aktmarrëveshjes për tokën në Jalë, Vuno, në datën 29.04.2003; (iii) në përgjigjet e dhëna për pyetësin nr. 3, të Komisionit, i cili i kërkon subjektit të depozitojë dokumentacion për të ardhurat e ligjshme që kanë shërbyer për blerjen e apartamenteve dhuruar asaj dhe për depozitën bankare dyemërore me nënën në BKT, subjekti ka depozituar edhe aktmarrëveshjen noteriale të nënës dhe z. A. Xh., pajisur me vërtetim noterial nënshkrimi më datë 29.04.2003.

15.5. Nga përmbajtja e aktmarrëveshjes së datës 29.4.2003, rezulton se në të përcaktohet se nëna e subjektit, në cilësinë e pronares së truallit të përfituar me vendim të Komisionit të Kthimit e Kompensimit të Pronave të vitit 1993 dhe të pasurisë “pyll-kullotë” me sip. 60.000 – 100.000 m², sipas së cilit këtyre të fundit duhet t’u konfirmohet (miratohet) e drejta e pronësive të bashkëpronarëve K. K. e M. K. - do t’i japë për zhvillim (ndërtim), pjesën e saj takuese në pronat e mësipërme, kur ato të zhvillohen, palës investitore. Investitori deklaroi që do t’i japë pronares së truallit (kullotë) si garanci kontraktuale shumën prej 15.500.000 lekësh, si parapagim. Palët, po ashtu, kanë dakordësuar që pasi palët të lidhin kontratën e sipërmarrjes dhe pasi pala bashkëpronare të zgjedhë sipërfaqet ndërtimore takuese, shuma e mësipërme do të zbritet nga sipërfaqet ndërtimore takuese, sipas konvertimit të bërë mes palëve. Së fundmi, pronarja e truallit do të konsiderohej e kompensuar për sipërfaqen ndërtimore, që i takon shumës së dhënë në vlerë monetare prej 15.500.000 lekësh.

15.6. Nga sa më sipër dhe nga aktet në fashikull, trupi gjykues evidenton që: (i) aktmarrëveshja parashikon që pala pronare e truallit do të konsiderohet e kompensuar për sipërfaqen ndërtimore që i takon shumës monetare prej 15.500.000 lekësh; (ii) aktmarrëveshja është lidhur në prill të vitit 2003, periudhë në të cilën subjekti i rivlerësimit nuk ushtronte detyrën e prokurores; (iii) aktmarrëveshja ka lënë gjurmë dokumentare nëpërmjet vërtetimit të nënshkrimit noterial në prill 2003²²; (iv) përmbajtja e aktmarrëveshjes evidenton²³ detyrimin e palës sipërmarrëse (A. Xh.) për marrjen në dorëzim të dokumentacionit të pronës²⁴, me qëllim zhvillimin në të ardhmen kundrejt një parapagimi²⁵, në vlerën rreth 15.500.000 lekë, për të cilën sipërmarrësi merr përsipër të hartojë dokumentacion për zhvillimin e pronës dhe nxjerrjen e aktit të pronësisë pranë çdo organi dhe hipotekës; (v) në aktet që subjekti ka paraqitur në Komision, me përgjigjet për pyetësonin nr. 7, rezulton se ka paraqitur disa foto nga Google Earth që tregojnë zhvillimin e një investimi në Jalë, Vuno, me të cilat subjekti kërkon të provojë zhvillimin e pasurisë; (vi) përmbajtja e aktmarrëveshjes dëshmon se marrëdhënia midis palëve nënshkruese të saj nuk përfundon, por fillon me lidhjen e saj dhe duket se do të zgjasë deri në përfitimin e pjesës respektive ndërtimore, pas zhvillimit të pronës nga sipërmarrësi.

²² Aktmarrëveshja është e pajisur me vërtetim nënshkrimi me nr. {***} rep., datë 29.04.2003, të lëshuar nga noteri A. M. (A.). Noterja ka evidentuar se: “Më datë 29.04.2003 u paraqitën personalisht pranë saj znj. L. S. dhe z. A. Xh., të cilët i kërkuan vërtetimin e nënshkrimeve në aktmarrëveshjen datë 29.04.2003, hartuar dhe nënshkruar jashtë kësaj zyre noteriale”. Në ligjin nr. 7829, datë 01.09.1994, “Për noterinë”, i ndryshuar, në nenin 55 parashikohet që: “Vërtetimi i nënshkrimeve bëhet për akte private që nuk përmbajnë lidhjen e një kontrate ose kryerjen e një veprimi tjetër juridik. Vërtetimi bëhet në fund të aktit, pas nënshkrimeve, duke u bërë shënimi nga noteri se personat u paraqitën personalisht dhe nënshkruan në prani të tij ose pranuan se nënshkrimet janë të tyre. Vërtetimi i nënshkrimeve në kushte të caktuara me ligj mund të bëhet edhe nga organe shtetërore”. Me ndryshimet që ka sjellë ligji nr. 9216/2004, nuk lejohet pajisja me “vërtetim nënshkrimi” për akte që nuk janë nënshkruar në prani të noterit.

²³ Në aktmarrëveshje përcaktohet se: “Pala sipërmarrëse, nga ana tjetër, pasi merr në dorëzim dokumentacionin e pronës, merr përsipër dhe ka për detyrë të fillojë menjëherë me procedurat përkatëse për hartimin e dokumentacionit për zhvillimin e pronës, pranë organeve ligjzbatuese, si dhe çdo organi tjetër të administratës shtetërore, hipotekës etj.”.

²⁴ Si i tillë në këtë akt identifikohet vetëm vendimi i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave nr. {***}, datë 13.09.1993.

²⁵ Në përgjigjet e pyetësonit nr. 7, subjekti i rivlerësimit shpjegon se: “Duke u kthyer në rastin e nënës time, ndërmjet palëve ka një aktmarrëveshje për parapagim të shumës. Referuar legjisllacionit të zbatueshëm nuk ka asnjë detyrim për pagimin e tatimit për këtë shumë. Do të duhej që palët të lidhnin kontratën e sipërmarrjes, shkëmbimit dhe më pas të kompensimit të shumës 15,500,000 lekë me pjesën takuese që do t’i përkiste nga ndërtimi dhe, në këtë moment, nënës sime do t’i lindte detyrimi për pagesën e tatimit në burim”.

15.7. Për sa më sipër, si dhe në konsideratë të të dhënave se: (i) në aktmarrëveshjen e datës 29.04.2003 ka përcaktim të qartë lidhur me pagimin e shumës prej 15.500.000 lekësh; (ii) fakti se në vitin 2003, nga të evidencat bankare ka të dhëna se nëna e subjektit ka hapur dy depozita përkatësisht, më datë 21.10.2003, në Intesa Sanpaolo Bank, në shumën 45.000 USD dhe në NBG në shumën 52.210 USD, depozita të cilat së bashku të konvertuara me kursin e këmbimit të kohës shkojnë në vlerën rreth 10.900.000 lekë, trupi gjykues i konsideroi si të dhëna/indicie që tregojnë në favor të besueshmërisë dhe materializimit të përfitimit nga nëna e subjektit të shumës së evidentuar në aktmarrëveshje. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit e vlerësoi të pabazuar pretendimin e Komisioneres Publike.

16. Komisionerja Publike ka pretenduar edhe që prindërit e subjektit në cilësinë e *personave të lidhur/dhurues* nuk provojnë burimet e ligjshme për pagesën e *këstit të tretë* në vitin 2012, për *apartamentin në Golem*, përpos mungesës së burimeve të ligjshme për prindërit, deri në fund të vitit 2005, në konsideratë të kredisë së marrë nga e ëma e subjektit, pranë NBG-së, në vitin 2010.

16.1. Komisioni nuk rezulton të ketë arritur në një konkluzion për kredinë, në funksion të analizës për krijimin e apartamentit në Golem. Konkretisht, në paragrafin 20.40, Komisioni shprehet se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë apartamentin në Golem dhe ka depozituar dokumentacion për të provuar burimet e ligjshme të prindërve për krijimin e kësaj pasurie. Komisioni ka përfshirë në analizë të ardhurat nga pasuritë e trashëguara të prindërve nga qiradhënia e ndërtesës së ish-Ambasadës Franceze, për periudhën 2007-17.06.2010. Duke theksuar edhe që detyrimin për pagimin e tatimit e ka pasur personi juridik, Komisioni ka konstatuar se nëna e subjektit është provuar të ketë pasur të ardhura të mjaftueshme për pagesën e kësteve për blerjen e kësaj pasurie në vitet 2005 dhe 2010. Komisioni shprehet se nga analiza financiare pas prapësimeve të subjektit ka rezultuar një balancë negative në shumën (-) 686.784 lekë për pagesën e këstit në vitin 2012. Për rrjedhojë, prindërit e subjektit kanë pasur mundësi të investojnë në këtë pasuri të paluajtshme dhe *nuk kemi të bëjmë* me pasuri të fshehur të subjektit të rivlerësimit.

16.2. Pas analizës së këtij shkaku ankimi, mbi bazën e akteve në fashikull dhe shpjegimeve të subjektit nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se edhe ky shkak ankimi është i pabazuar. Duke mbajtur në konsideratë të ardhurat në disponim të prindërve të subjektit, ndër të tjera, edhe ato të siguruar nga aktmarrëveshja e datës 29.04.2003, si dhe nga shitja dhe qiradhënia e pasurive të paluajtshme, trupi gjykues i Kolegjit konstatoi se analiza e kryer tregon se prindërit e subjektit kishin të ardhura të ligjshme të *konsiderueshme* për të financuar pagimin e kësteve të këtij apartamenti. Ky konkluzion mban në konsideratë që analiza financiare e të ardhurave të prindërve të subjektit mbetet me rezultate pozitive, qoftë nëse përfshihet kredia e marrë nga nëna e subjektit në bankë në vitin 2010, ashtu edhe në versionin kur kredia nuk përfshihet si e ardhur për financimin e kësaj pasurie. Arsyetimi mbi të cilin bazohet ky qëndrim shtjellohet në vijim.

16.3. Trupi gjykues evidenton se, ndryshe nga arsyetimi i Komisionit në vendim, nga verifikimi në Kolegji i zërave të analizës financiare të Komisionit për burimet e financimit të apartamentit në Golem, Kavajë, rezulton se kredia e marrë nga nëna e subjektit në NGB në janar të vitin 2010, në shumën 2.500.000 lekë, është përfshirë si e ardhur që ka shkuar për financimin e kësteve të paguara për këtë apartament, ndonëse subjekti nuk e ka deklaruar atë si një nga burimet e financimit të kësaj pasurie. Po ashtu, në kushtet që nga aktet provohet

shlyerja prej subjektit e disa prej kësteve të kredisë, ajo ka qenë në dijeni të këtij detyrimi të marrë përsipër nga nëna.

16.4. Nga deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën *vetting* dhe në deklaratat periodike vjetore, për apartamentin në Golem, Kavajë, trupi gjykues vëren sa vijon.

a. Në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar: Apartament banimi me sip. 84 m², blerë sipas kontratës së porosisë nr. {***}, datë 20.03.2012, në vlerën 72.000 euro (Golem, Kavajë). Subjekti ka deklaruar se si burim krijimi i kësaj pasurie kanë shërbyer të ardhura të familjes nga kontratat e qirave, shitja e pasurive të paluajtshme, të ardhura nga vëllai në Itali, etj. Deklaratat noteriale të hartuara për efekt të krijimit të kësaj pasurie [kontratat e porosisë në vitin 2005 dhe 2010] tregojnë se porositës ka qenë i ati i subjektit.

b. Në deklaratën periodike për vitin 2012, subjekti ka deklaruar apartamentin në fjalë, me vlerë 72.000 euro, krijuar nëpërmjet kontratës së porosisë. Ndërsa në rubrikën të dhëna konfidenciale subjekti ka deklaruar emrin e të atit, si personi që ka lidhje me pasurinë e paluajtshme. Kontrata noteriale e porosisë që mban datën 20.03.2012, nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit, sipërmarrësi [z. A. K.] dhe shoqëria ndërtuese [{"***"}], po ashtu, përcaktonte si objekt ndërtimin e një apartamenti, me sipërfaqe të përgjithshme 90,5 m² dhe sipërfaqe ndërtimore 81,5 m², çmimin 72.000 euro dhe këstet e pagesave.

16.5. E pyetur nga Komisioni për kredinë në shumën 2.500.000 lekë, që ka marrë e ëma në vitin 2010, në NBG, subjekti ka potencuar se banka e ka informuar se flitet për një kredi konsumatore të disbursuar në datën 11.01.2010 dhe shlyer totalisht në datën 10.11.2014, e cila duhet të jetë përdorur në funksion të kontratës noteriale të porosisë të datës 08.10.2010, për apartamentin në Golem, Kavajë. Subjekti ka shpjeguar edhe që këstet e shlyera prej saj, për të lehtësuar veprimet e nënës, kanë si burim të ardhurat e nënës. Për shkak të lëvizjeve të dokumentacionit, si pasojë e bashkimit të dy bankave të nivelit të dytë, nuk disponon fizikisht kopje të kontratës së kredisë.

16.6. Për sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se kredia afekton apartamentin e banimit me vendndodhje në Golem, Kavajë, për të cilën Komisionerja Publike argumenton se personi i lidhur/dhuruesi nuk provon me burime të ligjshme pagesën e këstit të tretë të kryer në vitin 2012, për shkak të mungesës së burimeve të ligjshme për prindërit, deri në fund të vitit 2005 dhe, në konsideratë edhe të kredisë së marrë nga nëna e subjektit në NBG, në vitin 2010.

16.7. Trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë që, sikurse arsyetuar edhe më sipër, prindërit e subjektit nuk janë konsideruar *persona të lidhur* nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, në asnjë fazë. Këtë cilësim nuk e ka kërkuar as vetë Komisionerja Publike nga Kolegji, sikurse nuk ka kërkuar e potencuar asnjë nevojë për vlerësim në këtë drejtim. Përkundrazi, në kushtet që në të njëjtin togfjalësh, ata cilësohen e referohen si “dhurues”, automatikisht ata hyjnë në analizë si *persona të tjerë* të lidhur, me pasojat përkatëse në procesin e rivlerësimit. E thënë ndryshe, kjo mënyrë shprehjeje/cilësimi e përdorur nga Komisionerja Publike është inkohrente dhe kontradiktore në vetvete.

16.8. Nga analiza e kryer për mundësinë e prindërve të subjektit si persona të tjerë të lidhur për të krijuar pasuritë objekt analize²⁶ deri në vitin 2012 e, në kufijtë e pasurive të dhuruara subjektit, pas korrektiveve të specifikuara në vijim, trupi gjykues i Kolegjit konstaton balancë pozitive deri në fund të vitit 2016 për të mbuluar shpenzimet e jetesës dhe për të justifikuar krijimin e pasurive të deklaruara nga subjekti në deklaratën *vetting*, si të krijuara/dhuruara nga prindërit e saj. Nën dritën e pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 dhe jurisprudencës së Kolegjit, në analizën e prindërve nuk u përfshinë pasuritë e prindërve që nuk i janë dhuruar apo me të cilat ata nuk kanë kontribuar në krijimin e pasurive të deklaruara në deklaratën *vetting*²⁷. Në analizën e prindërve të subjektit nuk janë përfshirë si elementë të analizës financiare as shuma prej 3.404.663 lekësh e pretenduar nga përfitimi i pjesës takuese të të ardhurave të pasurive të tezes së nënës së subjektit.

16.9. Nga ana tjetër, në këtë analizë, janë përfshirë në mesin e burimeve të ligjshme të disponuara nga prindërit e subjektit, sikurse arsyetuar gjerësisht më sipër: (i) të ardhurat nga qiradhënia e ndërtesës ish-Ambasadës Franceze²⁸ për periudhën 1995-2005; (ii) të ardhurat nga qiradhënia e të njëjtës ndërtesë shoqërisë ndërtuese “{***}”²⁹ ShPK, në pjesën takuese të nënës së subjektit [1/72 nga vlera totale e qirasë]; (iii) të ardhurat nga kontrata e datës 29.07.2001, për shitblerjen e truallit me sip. 1102 m² dhe ndërtesës 1-katëshe, në Tiranë, nga e cila nëna e subjektit ka përfituar shumën 4.306 USD; (iv) të ardhurat nga kontrata e shitjes datë 20.09.2002 -- truallit i zënë nga godina e shkollës {***}-- nga e cila nëna e subjekti të rivlerësimit ka përfituar shumën 18.854 USD; (v) të ardhurat si pasojë e aktmarrëveshjes së lidhur më datë 29.04.2003, për kullotat në Jalë, Vuno, nga e cila nëna e subjektit ka përfituar shumën 15.500.000 lekë; (vi) të ardhurat e prindërve të subjektit për të cilat u dokumentua pagesa mbi detyrimet tatimore³⁰ dhe nga punësimi i vetë subjektit deri në vitin 2002, sikurse edhe të ardhurat e prindërve nga pensioni i pleqërisë nga data 22.8.1994 dhe pension suplementar i të atit; dhe *së fundmi* (vii) kredia prej 2.500.000 lekësh e marrë pranë NBG-së, nga nëna e subjektit në vitin 2010.

16.10. Po ashtu, në analizën financiare të kryer në Kolegji, janë korrektuar/reduktuar të dhënat përkatësisht:

(i) përlllogaritja e *shpenzimeve të jetesës* për familjen e prindërve të subjektit në vitet 1993-2002, duke përdorur metodologjinë e aplikuar nga Kolegji³¹;

²⁶ Referuar në detaj në poshtëshënimin nr. 9 më sipër: dy apartamente – një në Tiranë dhe një në Golem – dy depozita bankare dy disaemërore me prindërit dhe dy llogaritë bankare të çelura nga nëna e subjektit në emër të secilës prej vajzave të saj përkatësisht në vitet 2004 dhe 2011.

²⁷ Duke përjashtuar gjendjet e likuiditeteve në depozitat dhe llogaritë bankare në emër të prindërve të subjektit, si dhe duke lënë jashtë analizës shpenzimet e prindërve për ndërtimin e objektit në rrugën “{***}”, në Tiranë, në vitet 1997, 1998, 2004, 2010 dhe 2011.

²⁸ Të ardhurat e përfituara nëpërmjet kontratës datë 30.03.1995, me qira mujore 7.338 USD, nëpërmjet kontratës datë 21.09.2000, me vlerë qiraje mujore 9.000 USD/muaj, nëpërmjet kontratës datë 27.01.2003, me qira mujore 9.000 USD, nëpërmjet kontratës datë 28.09.2005, me vlerë qiraje mujore 9.000 USD.

²⁹ Të ardhurat e përfituara nëpërmjet dy kontratave noteriale të qirave, përkatësisht në datat 23.01.2007 me qira mujore 9.000 euro, si dhe më 17.06.2009 me vlerë 9.000 euro/muaj.

³⁰ Përkatësisht, punësimi i nënës si mjeke nga viti 1994 e në vijim në Greqi për periudhën 1997-2002, në shumën totale 421.423 lekë.

³¹ Konkretisht, për periudhën 1993-1999, shpenzimet e jetesës janë përlllogaritur në 66% të të ardhurave nga pensionet dhe paga e subjektit. Komisioni i ka llogaritur shpenzimet e jetesës në masën 30% të të gjithë të ardhurave, duke përfshirë në to dhe të ardhurat nga qiradhënia. Për periudhën 2000-2003, shpenzimet e jetesës janë përlllogaritur sipas INSTAT-it.

- (ii) *shumat e dhuruara* nga nëna e subjektit vajzave të saj [subjektit]³²;
- (iii) në analizë janë korriguar *shtesat e likuiditeteve* në bankë, të cilat nuk janë reflektuar në analizën e Komisionit.

16.11. Për sa më sipër, nga analiza financiare e kryer sipas metodologjisë së mësipërme, për periudhën 1992-2012, trupi gjykues i Kolegjit konkludon se prindërit e subjektit të rivlerësimit rezultojnë me mundësi për kursim në shumën 17.957.203 lekë, në fund të vitit 2012. Për rrjedhojë, ata kanë mundësi të financojnë me burime të ligjshme të gjitha investimet e kryera për pasuritë e paluajtshme, si dhe për dhurimet e shumave monetare për subjektin dhe vajzat e saj. Në këto kushte, trupi gjykues çmon se edhe në opsionin e pretenduar nga Komisionerja Publike, për të mos përfshirë për apartamentin në Golem, kredinë e marrë nga nëna e subjektit në NBG, në vitin 2010, ky element i analizës nuk ka efekt mbi mundësitë financiare të prindërve në vlerësimin fundor për pagesat e kësteve të këtij apartamenti.

16.12. Në përfundim, trupi gjykues çmon se konkluzioni i Komisionit në vendim është i drejtë dhe i bazuar ligjërisht dhe janë bindëse shpjegimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me mundësinë financiare të prindërve të saj për krijimin e kësaj pasurie. Përveç se rezultuan burime të ligjshme të mjaftueshme të prindërve të subjektit të rivlerësimit për investimin në këtë pasuri, nga aktet në fashikull dhe analiza e kryer në Kolegj, nuk rezultuan rrethana në të cilat mund të vlerësohet i bazuar pretendimi i Komisioneres Publike për pasuri të fshehur të subjektit të rivlerësimit, sipas parashikimeve të pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjës “c” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

17. Pretendimi tjetër i Komisioneres Publike, lidhur me disponimin e likuiditeteve në *cash*, në shumën 10.000 euro, me burim kontratën e shitjes së vitit 2012, u vlerësua, gjithashtu, i pabazuar. Sipas ankimit, ky pretendim i subjektit ka mbetur në nivel deklarativ dhe nuk përputhet me aktet në dosje, ndërsa kërkimi i subjektit për përfshirjen në analizë financiare të shumës prej 14.500 eurosh, duket se është bërë në funksion të përmbysjes së analizës financiare negative të vitit 2015.

17.1. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se, në kushtet që subjekti ka identifikuar në deklaratën *vetting* kontratën noteriale nëpërmjet të cilës ajo ka përfituar këtë shumë, shpjegimet e subjektit nuk u vlerësuan si përpjekje për të përmbysur analizën financiare të vitit 2015. Ndonëse një shpjegim më i hollësishëm në deklaratën *vetting* do ta bënte më të qartë panoramën, mospasqyrimi i fjalës “dhurim”, për sa kohë është referuar saktësisht kontrata noteriale e premtim shitjes me datë, numër repertori e koleksioni, në saje të së cilës nëna e

³² Nga verifikimi i të dhënave nga Intesa Sanpaolo Bank, rezulton se të ardhurat e dhuruara nga nëna e subjektit për mbesën/vajzën e madhe të subjektit janë të ndryshme nga vlerat e vendosura nga Komisioni. Analiza e Kolegjit ka reflektuar shifrat e sakta, në total 9.300 USD. Në analizën e Kolegjit janë saktësuar edhe gjendja e depozitave në monedhën lekë në fund të vitit, për të cilat është korriguar efekti i kurseve të këmbimit, bazuar në kohën kur ka ndodhur kreditimi. Meqenëse depozitat janë çelur që në vitin 2004 dhe kurset e këmbimit kanë pasur ndryshime të konsiderueshme përgjatë periudhës 2004-2016, është më i drejtë konvertimi vetëm i pjesës së shtuar çdo vit, duke mos e ngarkuar gjendjen në fund të vitit me shtesa apo pakësime jo reale. Gjendja e fund vitit 2016, e përlllogaritur nga Kolegji, është në shumën 1.217.600 lekë, kundrejt shumës së përlllogaritur nga Komisioni, e cila ishte 1.494.868 lekë, me një diferencë jo reale prej 277.268 lekësh. Edhe për dhurimet në favor të vajzës së dytë të subjektit, është korriguar vlera e përlllogaritur nga Komisioni. Analiza e Kolegjit ka reflektuar shifrat e sakta që gjenerohen nga statementi bankar. Gjendja e korriguar në fund të vitit 2016 është 755.335 lekë, në vend të 829.010 lekë, përlllogaritur nga Komisioni.

saj ka fituar likuiditetet e dhuruara, provuar edhe nga aktet dokumentare, nuk mund të ngrihet në nivelin e pasaktësisë që duhet të passjellë masë disiplinore për subjektin e rivlerësimit.

17.2. Në këtë vlerësim, trupi gjykues mbajti në konsideratë se: (i) u konsiderua si një lapsus/deklarim i pasaktë në deklarin periodik të pasurisë të vitit 2015, deklarimi që pasqyron përkatësinë 100% nga subjekti i rivlerësimit të depozitës ku ishin kredituar këto të ardhura të krijuara me burime të ligjshme; (ii) të dhënat bankare, që dëshmojnë kreditimin e kryer në llogarinë e subjektit nga përfaqësuesja e një personi juridik në shumën që korrespondon me pjesën takuese të nënës së saj nga kontrata premtim shitje e datës 21.08.2012; dhe *së fundmi* (iii) evidentimin nga të dhënat bankare për tërheqjen e shumës nga subjekti i rivlerësimit në të njëjtën ditë kur kjo vlerë është kredituar në llogarinë e saj bankare, vlerësuar në raport me shpjegimet e subjektit se shumën e tërhequr nga llogaria bankare, ia ka dorëzuar nënës së saj, e cila në janar të vitit 2017 i dhuroi vlerën prej 10.000 eurosh që ishte pjesë/derivat i së njëjtës shumë. Arsyetimi mbi të cilin bazohet ky konkluzion shtjellohet në vijim.

17.3. Për këtë aspekt të kontrollit të pasurisë, Komisioni ka konkluduar se nuk krijoi dyshime lidhur me gjendjen *cash* të deklaruar në deklaratën *vetting*, me burim nga kontrata e premtim shitjes me palë nënën e subjektit. Komisioni, po ashtu, e ka konsideruar shumën e fituar – qoftë edhe në vlerën e pjesës takuese prej 9.500 eurosh -- të ligjshme, duke pasur në konsideratë që detyrimi i nënës së subjektit dhe trashëgimtarëve të tjerë nuk ka lindur për sa kohë kontrata përfundimtare e shitblerjes nuk është lidhur.

17.4. Pasi ka cituar jurisprudencën e Kolegjit³³, në të cilën deklaratat periodike vjetore të hartuara nga subjektet kanë marrë vlerën e provës, Komisionerja Publike potencon se subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të likuiditetit në formën *cash*, pasi: (a) nuk ka deklaruar shumën 10.000 euro në DVP-në 2015, si likuiditet në formën *cash* (në momentin e tërheqjes nga llogaria e saj të shumës 14.500 euro); (b) nuk ka deklaruar as në DVP-në 2016 pasjen e likuiditeteve në formën *cash*, në shumën 10.000 euro; dhe po ashtu (c) as në DVP-në 2017 nuk ka deklaruar disponim të likuiditeteve në formën *cash* apo si dhurim. Përveç sa më sipër, Komisionerja Publike pretendon se deklaratimet e subjektit për shumën 14.500 euro janë kontradiktore, pasi: (a) në përgjigje të pyetësorit nr. 5, subjekti ka deklaruar se shuma 14.500 euro ka kaluar në llogari të subjektit, por është tërhequr nga kjo e fundit për t'iu dhënë nënës së saj³⁴, ndërkohë në prapësime, subjekti ka kërkuar përfshirjen në analizë financiare të shumës 14.500 euro, duke argumentuar se vëllezërit e nënës i kanë dhuruar asaj shumën 5.000 euro, sikurse deklaruar në vitin 2022³⁵.

³³ Shih, ndër të tjera, vendimet e Kolegjit: (JR) nr. 6/2018, (JR) nr. 8/2018, (JR) nr. 9/2018, (JR) nr. 11/2018, (JR) nr. 12/2018, (JR) nr. 5/2019, (JR) nr. 19/2019, (JR) nr. 20/2019, (JR) nr. 5/2020 dhe (JR) nr. 27/2020.

³⁴ Në përgjigjet e pyetësorit 5, subjekti ka deklaruar që: “Shoqëria “***”[...] ka filluar të likuidojë trashëgimtarët. Znj. A. A. [...] është autorizuar në datën 10.04.2015, të kryejë në *cash* pagesën prej 14.500 eurosh. [dhurimi] i shumës 5.000 euro, nga dy dajat, ku secili i ka dhuruar nënës nga 2.500 euro. Nuk disponoj akt përfaqësimi nga nëna ime për kalimin në llogarinë time të shumës prej 14.500 eurosh. Kjo shumë ka kaluar në llogarinë time në datën 10.04.2015 dhe, po në të njëjtën ditë, kam tërhequr [...] i kam dorëzuar nënës të gjithë vlerën e tërhequr[...] u gjykua që pagesa të kalonte në llogarinë time për dokumentimin e saj dhe unë më pas të tërhiqja shumën duke ia dorëzuar nënës”.

³⁵ Në prapësimet për rezultatet e hetimit, në faqen 9, subjekti ka shpjeguar: “Gjithashtu përveç pjesës takuese të nënës në këtë pasuri, në analizën financiare kryer nga Komisioni duhet të përfshihet dhe shuma 5.000 euro, sipas konfirmimit të dhënë nga daja S. G.. Përmes deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 06.12.2022, [...] deklaroi se nga kontrata premtim shitjeje datë 21.08.2012 kanë përfituar secili 9.500 euro,

17.5. Në deklaratën *vetting*, subjekti është shprehur se disponon gjendje *cash* në banesë 10.000 euro, me burim krijimi “nga shitja e pasurisë së paluajtshme me kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.08.2012”. Në deklaratën periodike për vitin 2015, në rubrikën e dedikuara ndryshimeve të pasurisë dhe burimeve të krijimit, ajo ka deklaruar në të njëjtën formë, sikurse edhe në deklaratën *vetting*, duke specifikuar të ardhurat në vlerën 14.500 euro, ndërsa pjesë *takuese 100%*. Në shpjegimet e dhëna gjatë hetimit administrativ, subjekti ka pretenduar se shumën 14.500 euro e ka tërhequr si likuiditet në *cash* dhe ia ka dorëzuar nënës së saj. Ky veprim konfirmohet edhe nga aktet bankare kryer në datën 14.05.2015. Ndërkohë, në prapësim të rezultateve të hetimit, subjekti është shprehur se nuk ka deklaruar *shtim* të gjendjes *cash* në janar 2015 me burim *këtë shumë*, sepse dhurimi ka ndodhur në janar të vitit 2017. Subjekti ka specifikuar që ka përshkruar transaksionin e kryer në datën 10.04.2015, tërheqjen e shumës për llogari të nënës.

17.6. Sikurse konstatuar nga Komisioni, nga kontrata e premtim shitjes së një pasurie të paluajtshme në vitin 2012, e cila është paguar në vitin 2015, nëna e subjektit duket se ka përfituar më shumë se vlera prej 9.500 eurosh që i takonte asaj. Me shpjegimet e dhëna për rezultatet e hetimit, subjekti ka deklaruar se vlera prej 14.500 eurosh nuk duhet të konsiderohet si gjendje *cash* në analizën e vitit 2015, pasi ajo ia ka kaluar të gjithë shumën nënës ditën e tërheqjes në datën 14.05.2015. Është përdorur llogaria bankare e subjektit për lehtësi, edhe për pjesën prej 5.000 eurosh dhuruar nënës nga vëllezërit, për shkak të pamundësisë fizike të nënës.

17.7. Për sa evidentuar më sipër, edhe për këtë shkak ankimi, trupi gjykues konkludoi se është i drejtë qëndrimi i Komisionit në vendim se plotësohen kërkesat e për garantimin e ligjshmërisë së krijimit të shumës 10.000 euro, të përfituar prej subjektit nga nëna nëpërmjet kontratës së premtim shitjes. Sikurse Komisioni, edhe trupi gjykues i Kolegjit e konsideroi këtë shumë si burim të ligjshëm, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.

18. Në përfundim të analizimit të kriterit të vlerësimit të pasurisë, trupi gjykues i Kolegjit mori në shqyrtim pretendimet e ngritura në ankim nga Komisionerja Publike me të cilat ajo kundërshton analizën financiare të kryer nga Komisioni për periudhën 2003-2016, si të pasaktë për shkak të pranimit të pretendimeve të subjektit për: (i) konsiderimin e kursimeve në *cash* të deklaruara në DVP; (ii) reduktimin e shpenzimeve për udhëtime; (iii) konsiderimit të depozitave në emër të vajzave të subjektit, si të kredituara nga nëna e subjektit, e cila ka rezultuar me pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme për realizimin e këtyre dhurimeve; (iv) në analizën e kryer për blerjen e një automjeti në vitin 2014.

18.1. Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit, për periudhën 2003-2016, pasi përlllogariti shpenzimet e udhëtimit, sipas metodologjisë së përcaktuar në vendimin e tij (JR) 11/2019, identifikoi vlerat e akumuluar të kursimeve në *cash* vit pas viti, korrektoi vlerat e dhuruara nga nëna e subjektit për mbesat e saj sipas të dhënave të dokumenteve bankare, konstatoi se subjekti i rivlerësimit gjendet në mungesë burimesh të ligjshme për të mbuluar kostot e jetesës dhe investimet e kryera vetëm në dy vite, përkatësisht në vitin 2007 në shumën (-) 467.059 lekë dhe në vitin 2014 në shumën (-) 471.798 lekë, duke rezultuar në total për të

ku z. S. G. së bashku me vëllain tjetër [...] i kanë dhuruar motrës së tyre L. S. shumën prej 2.500 eurosh, secili, [...] depozituar në llogarinë bankare të vajzës Suela Salavaçi [...] kjo shumë është depozituar nga pala blerëse duke mos kaluar në llogaritë e tyre bankare, por direkt në llogarinë e mbesës Suela Salavaçi”.

gjithë periudhën e rivlerësimit me mungesë të ardhurash të ligjshme në shumën (-) 938.858 lekë. Në kuptim të përcaktimeve të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, kjo balancë u konsiderua e pamjaftueshme për të konsideruar se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se konkluzioni i vendimit të Komisionit, se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, është i drejtë dhe i bazuar ligjërisht. Analiza mbi të cilën bazohet ky konkluzion shtjellohet në detaj në vijim.

18.2. Nga analiza e akteve në fashikull, pretendimeve të Komisioneres Publike dhe shpjegimeve e akteve të sjella në procesin e zhvilluar në Kolegj nga subjekti, nën dritën e përcaktimeve të ligjit nr. 9049/2003, bazuar edhe në jurisprudencën e deritanishme, trupi gjykues vëren se shpjegimet e subjektit se ka deklaruar *gjendjet* në fund të vitit janë të pabazuara. Formulari i deklarimit periodik të pasurisë kërkon që subjektet deklarues të deklarojnë ndryshimet e pasurive, duke evidentuar vlerën *e shtuar* apo *pakësuar* dhe burimet e krijimit, pa përjashtuar nga ky rregull edhe kursimet në *cash*. Për rrjedhojë, duke i përlllogaritur si *kursime nga paga* nga subjekti dhe personi i lidhur, këto vlera në analizën e kryer në Kolegj u vlerësuan si *shtesa* likuiditeti në *cash* në fund të vitit, e iu nënshtruan analizës e përlllogaritjes nëse ato kanë pasur pakësime në vite, duke mbajtur në konsideratë deklaramet e subjektit në deklaramat periodike të interesave pasurore në periudhën 2003-2016, si dhe në deklaramtën *vetting*.

18.3. Lidhur me kursimet në *cash* të deklaramta nga subjekti në deklaramat periodike vjetore, Komisioni ka pranuar shpjegimet në hetimin administrativ dhe deklaramet në seancë, duke e rishikuar analizën financiare dhe konsideruar ato si *gjendje* likuiditetesh në fund të viteve përkatëse. Komisionerja Publike argumenton se kursimet e deklaramta nga subjekti ndër vite nuk përputhen me gjendjen kumulative të kursimeve nga viti 2007 deri në 2016, të cilat duhet të ishin në vlerën 6.095.925 lekë, nisur nga fakti se subjekti nuk ka deklaruar pakësim të kursimeve.

18.4. Trupi gjykues vëren se shumatorja e kursimeve të përlllogaritura nga Komisionerja Publike dhe fakti që subjekti nuk ka deklaruar pakësime, gjendet e evidentuar edhe në rezultatet paraprake të hetimit administrativ. Gjithashtu, në fashikullin e Komisionit gjendet procesverbali i mbajtur në datën 07.07.2016, në ILDKPKI, në të cilin subjekti ka deklaruar se gjendja e kursimeve *cash* deri në datën 31.12.2014 është në vlerën 1.000.000 lekë dhe 5.000 euro. Gjatë gjykimit të çështjes në Kolegj, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të njëjta me ato të deklaramta prej saj në Komision, duke evidentuar se flitet për *gjendje kursimesh* në datën e deklarimit. Sipas subjektit, në deklaramat periodike ndër vite ka deklaruar gjithmonë kursimin e vitit në *cash* ose në llogari bankare. Këto vlera janë përdorur brenda vitit, si burim krijimi për shtimin e pasurisë ose për përballimin e shpenzimeve. Në Kolegj dhe në Komision, subjekti ka shpjeguar edhe se deklarimi i saj në ILDKPKI, më datë 07.07.2016, se *gjendja cash në fund të vitit 2014 ka qenë 1.000.000 lekë dhe 5.000 euro*, është lapsus, i shkaktuar nga përlllogaritja e gabuar, duke u kthyer prapa në kohë nga data e deklarimit 07.07.2016, në datën 31.12.2014, që kërkohej të deklarohet gjendja *cash*. Po ashtu, gjatë gjykimit në Kolegj, subjekti ka pretenduar se në deklaramtën *vetting* ka deklaruar gjendje *cash* në shumën 10.000 euro, me burim kontratën e premtim shitjes dhuruar nga nëna në janar 2017. Për këtë arsye, ka deklaruar shumën e dhuruar, e cila ndodhej *cash* në banesë në momentin e përpilimit të kësaj deklarate. Në deklaramtën për vitin 2015, nga ana tjetër, ka

përshkruar vetëm transaksionin e datës 10.04.2015 ose ndryshe tërheqjen e shumës nga llogaria e saj bankare për t'iu dorëzuar nënës.

18.5. Trupi gjykues i Kolegjit, në analizë të pretendimeve të Komisioneres Publike dhe të prapësimeve të subjektit lidhur me to, çmoi të konsiderojë pjesërisht si të bazuara pretendimet e subjektit, lidhur me kursimet në *cash* të deklaruara në deklaratat periodike ndër vite, pasi analizoi se:

(i) *Së pari*, subjekti ndër vite deklaroi *kursime nga paga* pa specifikuar nëse janë të materializuara në *cash* apo në likuiditete në llogari bankare. Rezulton se vlerat e deklaruara për vitet 2007 dhe 2015, si kursime nga paga, korrespondonin me vlerat në fund të vitit si likuiditet në bankë. Për rrjedhojë, Kolegji pranoi se në këto dy vite subjekti *nuk* kishte kursime në *cash*.

(ii) *Së dyti*, për të gjitha vitet e tjera, në të cilat subjekti ka deklaruar *kursime nga paga*, ato u konsideruan të përbëra prej likuiditeteve të konfirmuara në bankë dhe kursim në *cash*, pjesa që mbetet. Për rrjedhojë, gjendja e *cash*-it të disponuar nga subjekti vit pas viti, në analizën e kryer në Kolegj, është identifikuar duke aplikuar detyrimet që lindin nga leximi i rubrikës përkatëse të deklarimit periodik të pasurisë, sipas ligjit nr. 9049/2003 dhe formularëve pjesë e tij, me fokus deklarimin e shtesave dhe pakësimit të likuiditeteve apo pasurive gjatë vitit kalendarik.

18.6. Pas aplikimit të qasjes dhe analizës së mësipërme, bazuar në dokumentacionin në fashikull, nga analiza e korrektuar në Kolegj, sipas kërkesës së Komisioneres Publike, trupi gjykues i Kolegjit konkludoi se gjendja *cash* e akumuluar nga subjekti në fund të vitit 2015 ishte 2.979.353 lekë³⁶. Kjo vlerë u përfshi/mbajt në konsideratë në analizën financiare.

- 19.** Zëri tjetër i analizës financiare që është objekt ankimi lidhet me shpenzimet e udhëtimit. Konkretisht, Komisioni ka konkluduar se pavarësisht pasaktësive në formën e mos-deklarimit në deklaratat periodike dhe atë vetting të mbulimit të shpenzimeve nga një person tjetër, ato nuk mund të sjellin pasojë në analizën e përgjithshme të subjektit dhe personit të lidhur pasi nuk janë kryer për fshehje pasurie. Në zbatim të parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit, rrethanat e konstatuara nuk përbëjnë arsye për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit dhe nuk kanë afektuar deklarimin në deklaratën vetting, përfundon Komisioni.

19.1. Komisionerja Publike potencon se subjekti ka pranuar dhurata në vlerë totale rreth 8.446 euro, për udhëtimet e kryera gjatë periudhës 2009-2019, të cilat ndikojnë në sjelljen e magjistratit jashtë detyrës. Subjekti nuk i ka deklaruar këto dhurime në deklaratat periodike vjetore, dhe nuk ka depozituar dokumentacion që provon ofertat me çmim promocional të përfituara nga agjencia turistike, për udhëtimet e kryera prej saj. Po ashtu, ajo potencon se shpenzimet për udhëtimet e kryera në periudhën 2004-2016, sipas standardit të Kolegjit, përlllogariten në vlerën totale 6.311.608 lekë. Komisioni ka marrë në konsideratë pretendimet e subjektit, duke reduktuar shpenzimet e udhëtimit nga në 4.581.302 ose pakësuar me rreth 1.700.000 (një milion e shtatëqind mijë) lekë. Ky reduktim vjen kryesisht³⁷ si rezultat i

³⁶ Kjo vlerë rezulton të jetë e ndryshme nga shuma e përlllogaritur nga Komisioni në shumën prej 500.000 lekësh.

³⁷ Përjashtim bëjnë disa raste, kur subjekti i rivlerësimit, pas prapësimeve, ka provuar me dokumentacion se kostot janë mbuluar nga punëdhënësi (në rastin e udhëtimeve të bashkëshortit).

marrjes në konsideratë të pretendimeve të subjektit mbi mbulimin e shpenzimeve nga shoqëria “{***}” ShPK apo të tjerë.

19.2. Trupi gjykues evidenton se çështjet që shtrohen për analizë kanë të bëjnë me nëse: (i) subjekti i rivlerësimit, në kuptim për përcaktimeve të ligjit nr. 9367/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar (në vijim ligji nr. 9367/2005), ka pasur detyrimin për të deklaruar në deklaratat periodike vjetore dhurimet e përfituara për udhëtime; dhe (ii) nëse deklaratimet e bëra nga subjektet tregtare gjatë procesit të rivlerësimit duhet të konsiderohen me vlerë provuese, në kushtet që deklarojnë mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit të subjektit dhe familjes ndër vite.

19.3. Subjekti ka shpjeguar se familja e saj ka marrëdhënie të ngushta miqësore me përfaqësuesen e shoqërisë “{***}” ShPK [znj. E. Gj.], dhe që në praktikën e Komisionit dhe të Kolegjit shpenzimet e udhëtimit të mbuluara nga të afërm apo miq nuk janë konsideruar si shpenzime të deklarueshme (apo dhurime), pasi nuk janë shpenzime të kryera nga subjekti. Subjekti po ashtu ka pretenduar se nuk ka qenë në kushtet për të deklaruar dhurimet e bëra nga mikja e saj në deklaratat periodike të pasurisë pasi ajo nuk ka përfituar në mënyrë direkte dhurime në shuma monetare. Subjekti ka evidentuar se mikja e saj, për shkak të marrëdhënies së ngushtë që kanë, ka kryer për të pagesa për shpenzime udhëtimi (pagesa biletash apo akomodim në hotele), të cilat nuk ia ka bërë të ditura subjektit. Për rrjedhojë, ajo ka qenë në pamundësi për t’i deklaruar shumat e shpenzuara për udhëtimet që subjekti ka realizuar.

19.4. Mbi bazën e dokumenteve të paraqitur në Komision, referuar në vijim, subjekti ka kërkuar që shpenzimet e udhëtimit të mbuluara nga përfaqësuesit e shoqërisë “{***}” ShPK të mos i ngarkohen asaj në analizën financiare, sipas praktikës dhe standardit të Kolegjit, në zbatim edhe të parimit të barazisë përpara ligjit. Konkretisht, subjekti ka përcjellë aktet si vijon:

(a) Vërtetim datë 11.09.2023 nga shoqëria “{***}” ShPK, referuar të cilit subjekti dhe familjarë të saj kanë blerë biletat e avionit në periudhat e deklaruara sipas politikave të shitjeve të kompanive ajrore, që janë: (i) rezervime të hershme që ofrohen me çmime simbolike për efekt marketingu; (ii) rezervime në periudha të sezonit të ulët që janë me çmime ekonomike; (iii) shfrytëzimi i ofertave të ndryshme që bëjnë kompanitë në ditë dhe data të caktuara.

(b) Vërtetim datë 11.09.2023, ku e njëjta shoqëri ka ritheksuar se për paketat turistike në Antalia në gusht/verë 2009 – 2012, subjekti ka paguar vetëm pjesën e akomodimit në hotel me të gjitha përfshirë, ndërsa për biletat *charter* janë shfrytëzuar vendet bosh në ato data udhëtimi. Shoqëria ka theksuar se agjencitë turistike herë pas here kanë vende të mbetura bosh në *charter*, të cilat mund të ofrohen falas si pjesë e paketës turistike.

(c) Vërtetim datë 11.09.2023, ku kjo shoqëri konfirmon se për paketat turistike në Antalia në gusht 2013 – 2016 subjekti ka paguar vetëm shpenzimet e udhëtimit, ndërsa për akomodimin në hotel [me të gjitha përfshirë] janë shfrytëzuar dhomat që merren falas nga agjencia, në bazë të kontratave me hotele të veçanta. Agjencia ka kontrata ekskluzive me disa hotele, që si pjesë e marrëveshjes përfshihen dhoma falas, që mund të shfrytëzohen nga agjencia me qëllim marketingu.

19.5. Trupi gjykues i Kolegjit, nga sa më sipër, si dhe nga analizimi i akteve të hetimit administrativ, konstaton se qëndron pretendimi i Komisioneres Publike se subjekti nuk ka

deklaruar përfitimet në formën e mbulimit të një pjese të kostos së udhëtimeve nga të tretë në periudhën kohore 2003 – 2016. Këto përfitime janë deklaruar për herë të parë me pyetësorin nr. 1 (standard)³⁸. Të gjitha vërtetimet (44 të tilla) nga shoqëria e udhëtimeve “{***}” ShPK, rezultojnë të jenë lëshuar në tetor 2023, kur subjekti i rivlerësimit ka qenë në proces rivlerësimi në Komision, dhe ato nuk rezultojnë të jenë shoqëruar me akte të kohës kur janë realizuar udhëtimet, si bileta apo prenotime/rezervime apo pagesa hotelesh që provojnë vlerat e shpenzuara. Po ashtu, sikurse potencon Komisionerja Publike, Komisioni ka reduktuar vlerën e shpenzimeve të udhëtimit të përfshirë në analizë në këto vite, duke e pranuar mbulimin e tyre nga shoqëria “{***}” ShPK për vitet 2005, 2007, 2011, 2013, 2014, dhe 2015.

19.6. Trupi gjykues i Kolegjit, analizoi aktet në fashikull nën dritën e metodologjisë së pasqyruar në jurisprudencën e mëparshme dhe kreu një analizë financiare duke mbajtur në konsideratë sa vijon: (i) udhëtimet për të cilat gjatë hetimit administrativ në Komision subjekti ka paraqitur një sërë aktesh në të cilat referohet se një agjenci turistike/pronarja e saj ka mbuluar, sipas rastit, shpenzimet e udhëtimit të subjektit e të familjarëve të saj, kostot e qëndrimit apo të dyja së bashku. Në të gjitha udhëtimet për të cilat në këto akte deklarohet vlera e kostove të udhëtimit dhe të akomodimit të subjektit, ato duhen përfshihen si të tilla në analizën financiare; (ii) për udhëtimet në të cilat subjekti ka qëndruar pranë familjarëve apo miqve të saj dhe sjellë dokumentacion mbështetës, në analizën financiare të kryer u përllogaritën shpenzimet e udhëtimit sipas metodologjisë së pasqyruar në vendimin e Kolegjit (JR) nr. 11/2019.

19.7. Nga analiza financiare e kryer sipas kësaj metodologjie, Kolegji përftoi një rezultat të ndryshëm nga ai i arritur nga Komisioni për këto shpenzime, që afekton analizën financiare si vijon: (i) në vitin 2005³⁹, shpenzimet e udhëtimit të Komisionit në shumën 900 euro nga Kolegji janë përllogaritur në vlerën 1.256 euro; (ii) në vitin 2007⁴⁰, shpenzimet e udhëtimit

³⁸ Në ketë pyetësor, subjekti ka deklaruar: “[...] Nga mikesha ime E. Gj., administratore e “{***}” janë financiar disa nga udhëtimet e mia dhe familjarëve të mi jashtë shtetit, udhëtime në të cilat ka qenë edhe E. dhe/ose familjarë të saj. [...] Nuk jam në dijeni të shumave të paguara prej saj”.

³⁹ Në vitin 2005: Shpenzimet e udhëtimit të përllogaritura u korrigjuan pjesërisht për shkak të dokumentacionit justifikues të përcjellë nga subjekti për udhëtimet e punës të kryera nga bashkëshorti (në vlerën 1.100 euro). Komisioni ka korrigjuar dhe shpenzimet e subjektit 110.286 lekë (ekuivalent me vlerën 900 euro) në vendim për udhëtimin e periudhës 06.11.2005-15.01.2006 (70 ditë) në SHBA, duke marrë në konsideratë deklaratën e datës 13.02.2020 nga kushëriri i subjektit, i cili shprehet se ka mbuluar tërësisht shpenzimet e qëndrimit të subjektit. Bazuar në metodologjinë e Kolegjit, shpenzimet e udhëtimit të sipërcituar në SHBA për periudhën 70 ditore korrektohen, duke u përllogaritur me kosto qëndrimi 5 euro/ditë për çdo ditë qëndrimi me një vlerë totale prej 350 euro (70 ditë x 5 euro = 350 euro). Gjithashtu vlera e biletës u përllogarit në masën 600 USD ekuivalent me 506 euro. Shpenzimet e udhëtimit të vitit 2005 sipas përllogaritjes së Kolegjit do të jenë në masën 1.256 euro.

⁴⁰ Në vitin 2007: Shpenzimet e udhëtimit të përllogaritura nga Komisioni janë në shumën 137.233 lekë, pasi janë reflektuar pretendimet e subjektit, e cila shprehet se kostoja ka qenë 50 euro, pasi shpenzimet e udhëtimit dhe qëndrimin janë përballuar nga ish-ambasadori i Shqipërisë në zyrën e OKB-së në Gjenevë, z. V. Th.. Subjekti ka përcjellë në Komision një deklaratë noteriale të pritësit, lëshuar në datën 11.09.2020, sipas të cilit subjekti është akomoduar në ish-banesën e deklaruesit dhe çdo shpenzim për këtë udhëtim është përballuar prej tij e bashkëshortes. Bazuar në metodologjinë e Kolegjit, udhëtimi në Gjenevë u përllogarit në shumën 210 euro [5 euro/ditë si dhe shpenzime për biletë me avion, 180 euro.] Sipas subjektit, për udhëtimin 10-ditor me paketë turistike në Antalia për vitin 2007, vlera e shpenzuar është 550 euro për shkak të ofertimit nga mikja e saj e ngushtë/ortake e vetme e shoqërisë. Subjekti ka përcjellë në Komision vërtetimet e datës 11.09.2023 nga shoqëria në fjalë, në të cilin rezulton se deri në vitin 2012 shoqëria ka pasur në dispozicion paketa me çmime të favorshme, ndërsa për biletat e charterit nuk ka paguar, duke shfrytëzuar vendet bosh në ato data udhëtimi. Në analizën e kryer në Kolegji, referuar vërtetimit të datës 07.10.2020, “{***}” informon se subjekti ka mbyllur biletën për në Antalia në vitin 2007 (2 të rritur dhe 1 fëmijë) në çmimin 550 euro, është përllogaritur kosto e

të përlloraritura nga Komisioni, në shumën 1.135 euro, nga Kolegji janë përlloratur në vlerën 1.395 euro; (iii) në vitin 2011⁴¹, shpenzimet e udhëtimit janë në të njëjtën vlerë, qoftë në analizën financiare të Komisionit, ashtu edhe në Kolegj, në vlerën 1.070 euro; (iv) në vitin 2013⁴², shpenzimet e udhëtimit të Komisionit në shumën 1.995 euro, nga Kolegji janë përlloratur në vlerën 2.035 euro; (v) në vitin 2014⁴³, shpenzimet e udhëtimit të Komisionit,

qëndrimin prej 650 euro [5 euro/ditë për person dhe kostoja 550 euro e referuar nga agjencia]. Shpenzimet e udhëtimit të vitit 2007 sipas përlloraritjes së Kolegjit do të jenë në masën 1.395 euro.

⁴¹ Në vitin 2011: Shpenzimet e udhëtimit të përlloraritura nga Komisioni para rezultateve të hetimit ishin në shumën 394.155 lekë. Komisioni ka pranuar pretendimet e subjektit se shpenzimet e udhëtimit për vitin 2011 duhet të jenë në shumën 137.233 lekë pasi ato duhet të korrigjohen sipas deklarimeve dhe dokumentacionit justifikues ligjor të paraqitur nga subjekti. Subjekti, në mbështetje të këtij pretendimi, ka përcjellë në Komision vërtetimin e datës 11.09.2023 lëshuar nga shoqëria “{***}” i cili informon që subjekti i rivlerësimin, për paketat turistike në Antalia në periudhat, Gusht 2009, verë 2010, verë 2011, verë 2012, ka paguar vetëm pjesën e akomodimit në hotel me të gjitha të përfshira, ndërsa për biletat e charterit janë shfrytëzuar vendet bosh në datat e udhëtimit. Sipas Kolegjit, udhëtimi 14-ditor për Antalia duhet të përllorartet sipas vërtetimit të lëshuar nga agjencia me kosto udhëtimi prej 520 euro. Referuar udhëtimit 3-ditor në drejtim të Budapestit, subjekti ka pretenduar një shpenzim me paketë turistike në masën 600 euro. Kolegji do të konsiderojë vlerën e deklaruar nga subjekti në masën 600 euro për faktin se ajo ka deklaruar që ka përfutuar oferta të lira preferenciale. Shpenzimet e udhëtimit të vitit 2011 sipas përlloraritjes së Kolegjit do të jenë në masën 1.710 euro.

⁴² Në vitin 2013: Shpenzimet e udhëtimit të përlloraritura nga Komisioni para rezultateve të hetimit ishin në shumën 722.783 lekë. Komisioni ka pranuar pretendimet e subjektit se shpenzimet e udhëtimit për vitin 2013 duhet të jenë në shumën 279.719 lekë, pasi ato duhet të korrigjohen sipas deklarimeve dhe dokumentacionit justifikues ligjor të paraqitur nga subjekti. Në lidhje me udhëtimin (14-ditor) për në Antalia në datat 2-16 gusht 2013, të përlloratur fillimisht nga Komisioni në shumën 2.640 euro, subjekti ka pretenduar se ka përdorur një paketë turistike, ku shpenzimet gjithsej për qëndrimin dhe udhëtimin kanë qenë në shumën 620 euro. Subjekti, në mbështetje të këtij pretendimi, ka përcjellë në Komision Vërtetimin datë 11.09.2023 të lëshuar nga agjencia “{***}” nëpërmjet të cilit informohemi që Suela Salavaçi, për paketën turistike për në Antalia në periudhën 2-16 gusht 2013, ka paguar vetëm pjesën e udhëtimit, ndërsa për akomodimin në hotel me të gjitha të përfshira janë shfrytëzuar dhomat që merren falas nga agjencia në bazë të kontratave me hotele të veçanta. Sipas Kolegjit, udhëtimi 14-ditor për Antalia duhet të përllorartet sipas vërtetimit të lëshuar nga agjencia dhe me kosto udhëtimi prej 620 euro. Në lidhje me udhëtimin (4-ditor) për në Barcelonë, në datat 22.08.2013 - 26.08.2013, të përlloratur fillimisht nga Komisioni sipas metodologjisë së Kolegjit në shumën 1.375 euro, subjekti ka pretenduar që është mbuluar financiarisht nga E. Gj. dhe vlera e këtij udhëtimi ka qenë zero lekë. Subjekti, në mbështetje të këtij pretendimi, ka përcjellë në Komision deklaratën noteriale datë 10.09.2020, të lëshuar nga E. Gj. e cila deklaron se Suela Salavaçi ka qenë disa herë e ftuar prej saj, konkretisht [...] në datat 22.08.2013 - 26.08.2013, në Barcelonë familjarisht ku shpenzimet janë mbuluar prej saj. Deklaruesja deklaron se Suela Salavaçi asnjëherë nuk ka qenë në dijeni të vlerave monetare të këtyre shpenzimeve pasi kanë qenë dhurata të bëra prej saj me dëshirën e saj të plotë për shkak të marrëdhënieve shumë të ngushta. Sipas Kolegjit janë përlloratur shpenzimet e udhëtimit me 5 euro/ditë për person dhe kosto udhëtimi sipas metodologjisë së Kolegjit. Shuma totale e shpenzimit është përlloratur në masën 755 euro. Në lidhje me udhëtimin (4-ditor) për në Amsterdam/Bruksel, subjekti, në mbështetje të këtij pretendimi, ka përcjellë në Komision vërtetimin e datës 07.10.2020 të lëshuar nga shoqëria “{***}” i cili informon që subjekti i rivlerësimin ka mbyllur paketë turistike për në Amsterdam dhe Bruksel në datat 28.11.2013-02.12.2013, ku çmimi total ka qenë rimbursim nga Alitalia për overbook në udhëtimin e Paris 2012. Komisioni ka përlloratur si kosto udhëtimi, vlerën e biletave prej 180 euro personi dhe shpenzime ditore në vlerën 5 euro/ditë për 3 persona, në një total prej 660 euro. Sipas Kolegjit, udhëtimi 4-ditor për Amsterdam/Bruksel duhet të përllorartet sipas vërtetimit të lëshuar nga agjencia dhe me kosto udhëtimi prej 660 euro. Shpenzimet e udhëtimit të vitit 2013 sipas përlloraritjes së Kolegjit do të jenë në masën 2.035 euro.

⁴³ Në vitin 2014: Shpenzimet e udhëtimit të përlloraritura nga Komisioni para rezultateve të hetimit ishin në shumën 682.896 lekë. Komisioni ka pranuar pretendimet e subjektit se shpenzimet e udhëtimit për vitin 2014 duhet të jenë në shumën 275.877 lekë, pasi ato duhet të korrigjohen sipas deklarimeve dhe dokumentacionit justifikues ligjor të paraqitur nga subjekti. Në lidhje me udhëtimin 2-ditor për në Romë, subjekti, në pyetësonin nr. 1, ka deklaruar se A. G. i ka dhuruar një udhëtim në Itali me vlerën 350 euro. Subjekti ka përcjellë në Komision vërtetimin datë 07.10.2023 të lëshuar nga A. G. e cila informon që subjekti i rivlerësimin në datat 18.01.2014-20.01.2014 ka qenë e ftuar prej saj, si dhe çdo shpenzim e ka pasur të mbuluar. Subjekti, në përgjigje të pyetësonit nr. 1 (udhëtimet), ka deklaruar se ka shpenzuar vetëm 20 Euro. Nga ana e Komisionit shpenzimet e këtij udhëtimi fillimisht janë përlloratur në masën 280 euro. Sipas Kolegjit, meqenëse subjekti ka qenë i ftuar tek A. G., shpenzimet janë përlloratur në masën 5 euro/ditë që së bashku me biletën e udhëtimit prej 180 euro, përbëjnë shpenzim për këtë udhëtim në vlerën totale 190 euro. Në lidhje me udhëtimin e datave 14-16/03.2014 (dalje në Muriqan), subjekti ka deklaruar që ka përdorur një paketë turistike në vlerën 170 euro (110 kosto qëndrimi dhe 60 euro kosto për udhëtimin). Nga ana e Komisionit shpenzimet e këtij udhëtimi

në shumën 955 euro, nga Kolegji janë përlllogaritur në vlerën 2.141 euro; (iv) në vitin 2015⁴⁴, shpenzimet e udhëtimit të Komisionit në shumën 3.215 euro nga Kolegji janë përlllogaritur në vlerën 2.840 euro.

19.8. Në vijim, dhe përpos sa më sipër, në përgjigje të pretendimit të Komisioneres Publike për të reflektuar në analizë kreditimet e bëra në mënyrë të përvitshme nga nëna e subjektit në favor të mbesave të saj, meqenëse ajo e cila ka rezultuar me pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme për realizimin e këtyre dhurimeve, një ndër elementët e analizës financiare të prindërve të subjektit, janë edhe llogaritë bankare të mbesave të saj (vajzave të subjektit). Në analizën e mësipërme, sikurse referuar në paragrafin 16.10 të këtij vendimi, si dhe në shpjegimet e dhëna në poshtëshënimin përkatës nr. 32, janë evidentuar në mënyrë të plotë pasaktësitë e analizës financiare të Komisionit lidhur me vlerat e dhuruara mbesave. Siç është shtjelluar më sipër, në kushtet kur nëna e subjektit ka rezultuar me burime të ligjshme për të

*fillimisht janë përlllogaritur në masën 360 euro. Kolegji, në lidhje me këtë udhëtim, argumenton që subjekti nuk ka dorëzuar në Komision dokumentacion justifikues të kohës për të provuar që udhëtimi ka kushtuar vlerën e pretenduar nga subjekti. Në këto kushte, shpenzimet e udhëtimit duhet të përlllogariten nga Kolegji sipas metodologjisë së përcaktuar. Shuma e shpenzuar për këtë udhëtim do të konsiderohet në vlerën 360 euro. Në lidhje me udhëtimin e datës 23.03.2014, subjekti ka deklaruar që ka bërë një udhëtim vajtje-ardhje me kosto 55 euro në Tushemisht. Nga ana e Komisionit shpenzimet e këtij udhëtimi fillimisht janë përlllogaritur në masën 130 euro. Sipas Kolegjit, në lidhje me këtë udhëtim, subjekti nuk ka dorëzuar në Komision dokumentacion justifikues të kohës për të provuar që udhëtimi ka kushtuar vlerën e pretenduar nga subjekti. Në këto kushte, shpenzimet e udhëtimit duhet të përlllogariten nga Kolegji sipas metodologjisë së përcaktuar. Shuma e shpenzuar për këtë udhëtim do të konsiderohet në vlerën 130 euro. Në lidhje me udhëtimin (13-ditor) për në SHBA, subjekti, në mbështetje të këtij pretendimi, ka përcjellë në Komision deklaratën noteriale nr. {***}, datë 01.09.2020 të lëshuar nga E. Gj., e cila informon që subjekti i rivlerësimi në datat 16.5.2014-29.05.2014 ka qenë e ftuar dhe është pritur prej saj si dhe çdo shpenzim e ka pasur të mbuluar. Në këtë udhëtim subjekti ka qenë e shoqëruar nga motra e E., A. L.. Subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. 1 (udhëtimet), ka deklaruar se ka shpenzuar vetëm 80 USD. Nga ana e Komisionit shpenzimet e këtij udhëtimi janë përlllogaritur në masën 1.014 euro. Sipas Kolegjit, meqenëse subjekti ka qenë e ftuar nga znj. Gj., shpenzimet e udhëtimit janë llogaritur në masën 5 euro/ditë (për 13 ditë), që së bashku me shpenzimet e udhëtimit prej 487 euro, përbëjnë një total shpenzimi prej 552 euro. Në lidhje me udhëtimin (14- ditor) të datës 06-20 gusht 2014, subjekti ka deklaruar se ka përdorur një paketë turistike me charter në vlerën 500 euro, në mbështetje të së cilës ka përcjellë në Komision vërtetimin e datës 11.09.2023 të lëshuar nga znj. Gjonpalaj e cila informon që subjekti ka paguar vetëm pjesën e udhëtimit, ndërsa për akomodimin me të gjitha të përfshira, janë shfrytëzuar dhomat që merren falas nga agjencia në bazë të kontratave me hotele të veçanta. Nga ana e Komisionit shpenzimet e këtij udhëtimi fillimisht janë përlllogaritur në masën 2.400 euro, më pas janë reduktuar në vlerën 500 euro sipas pretendimit të subjektit. Sipas Kolegjit shpenzimi i udhëtimit 14-ditor, duhet të përlllogaritet sipas vërtetimit të lëshuar nga agjencia dhe me kosto totale prej 500 euro. Në lidhje me udhëtimin e datës 28-30.11.2014, subjekti ka deklaruar që ka bërë një udhëtim me paketë turistike me kosto 160 euro (60 euro shpenzime udhëtimi + 100 euro shpenzime qëndrimi). Nga ana e Komisionit shpenzimet e këtij udhëtimi fillimisht janë përlllogaritur në masën 360 euro. Kolegji, në lidhje me këtë udhëtim, argumenton që subjekti nuk ka dorëzuar në Komision dokumentacion justifikues të kohës për të provuar që udhëtimi ka kushtuar vlerën e pretenduar nga subjekti. Në këto kushte shpenzimet e udhëtimit duhet të përlllogariten nga Kolegji sipas metodologjisë së përcaktuar. Shuma e shpenzuar për këtë udhëtim do të konsiderohet në vlerën 360 euro. Shpenzimet e udhëtimit të vitit 2014 sipas përlllogaritjes së Kolegjit do të jenë në masën 2.141 euro.*

⁴⁴ Në vitin 2015: Shpenzimet e udhëtimit të përlllogaritura nga Komisioni para rezultateve të hetimit ishin në shumën 642.137 lekë. Komisioni ka pranuar pretendimet e subjektit për shpenzimet e udhëtimit për vitin 2015 dhe i ka reduktuar ato në shifrën 442.545 lekë. Në lidhje me udhëtimin (15-ditor) për në Antalia në datat 5-20 Gusht 2015, të përlllogaritur fillimisht nga Komisioni në shumën 2.925 euro, subjekti ka pretenduar se ka përdorur një paketë turistike, ku shpenzimet gjithsej për qëndrimin dhe udhëtimin kanë qenë në shumën 1.100 euro. Subjekti në mbështetje të këtij pretendimi ka përcjellë në Komision vërtetimin datë 11.09.2023 të lëshuar nga agjencia "{***}" nëpërmjet të cilit informohemi që Suela Salavaçi për paketën turistike për në Antalia në periudhën 5-20 gusht 2015 ka paguar vetëm pjesën e udhëtimit, ndërsa për akomodimin në hotel me të gjitha të përfshira janë shfrytëzuar dhomat që merren falas nga agjencia me bazë të kontratave me hotele të veçanta. Sipas Kolegjit, shpenzimi i udhëtimit 15-ditor për Antalia, duhet të përlllogaritet sipas vërtetimit të lëshuar nga agjencia dhe me kosto totale prej 1.100 euro. Shpenzimet e udhëtimit të vitit 2015, sipas përlllogaritjes së Kolegjit, do të jenë në masën 2.840 euro.

justifikuar dhurimet në shuma monetare për mbesat, në analizën financiare të kryer në Kolegj janë përfshirë si dhurime vlerat e korrektuara sipas shumave të përcaktuara në statementet e llogarive bankare të vazhdate të subjektit të administruara në fashikullin e Komisionit.

20. *Së fundmi*, Komisionerja Publike pretendon se rezultati i analizës financiare të kryer nga Komisioni për periudhën 2003-2016, ka pasaktësi në analizën e vitit 2014, që lidhet me automjetin e blerë nga subjekti atë vit [marka Nissan Juke]. Komisionerja Publike potencon se subjekti i rivlerësimit ka qenë në pamjaftueshmëri financiare për të financuar me të ardhura të ligjshme këtë investim në datën 15.05.2014, dhe se ajo nuk provoi të kundërtën e barrës së provës. Këtë pretendim ajo e mbështet në: (i) deklaratën e bëra nga subjekti në procesverbalin e ILDKPKI-së në datën 07.07.2016 se në vitin 2014 ka pasur gjendje *cash* 1.000.000 lekë dhe 5.000 euro, në dispozicion për blerjen e automjetit; (ii) deklaratën në procesverbalin e ILDKPKI-së për likuiditetin *cash* të vitit 2014; (iii) deklaratën e subjektit në deklaratën periodike për vitin 2014, në të cilën ajo nuk ka deklaruar pakësim të likuiditetit *cash*, si burim për blerjen e automjetit.

20.1. Në përfundim të hetimit administrativ për këtë pasuri, Komisioni ka konkluduar se shpjegimet e subjektit se çmimi i blerjes së këtij automjeti nuk është preferencial, janë bindëse dhe që nuk rezultoi situatë konflikti interesi mes saj dhe qiramarrëses A. M. Automjeti është blerë në vitin 2011 dhe ka pësuar amortizim pas tre vitesh. Sa i përket balancës negative, nisur nga shpjegimet e subjektit, Komisioni ka reflektuar në analizë financiare gjendjet e kursimeve *cash* të saktësuara prej saj. Për rrjedhojë, analiza financiare për vitin 2014 pas prapësimeve ka rezultuar me balancë pozitive. Nga ana tjetër, në analizën financiare të kryer në *momentin* e blerjes së automjetit, në datën 15.05.2014, Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka pasur balancë negative të burimeve të ligjshme për kryerjen e këtij investimi, në shumën (-) 620.459 lekë.

20.2. Në përgjigje të pretendimit të Komisioneres Publike për mënyrën e përlllogaritjes së mundësisë së blerjes së këtij automjeti në datën 15.05.2014 nga personi i lidhur me subjektin, trupi gjykues i Kolegjit vëren se, në kushtet që subjekti ka identifikuar si burim “*të ardhura familjare*”, dhe duke mbajtur në konsideratë edhe arsyetimet e mëparshme për transaksione të kryera me burime të disponuara e deklaruara nga subjektet, analiza e burimeve të ligjshme u krye duke përfshirë kursimet sipas deklaratës në deklaratën periodike vjetore për vitin 2013. Ky konkluzion u mbështet në arsyetimin e shtjelluar në vijim.

20.3. *Së pari*, nga aktet në fashikull rezulton se në deklaratën *vetting* subjekti ka deklaruar këtë pasuri, me targën përkatëse, identifikuar mënyrën e fitimit [nëpërmjet kontratës së shitjes me Landeslease], datën 15.05.2014 dhe çmimin, në shumën 6.690 euro. Si burim të krijimit, subjekti ka deklaruar të ardhurat familjare. Pjesa takuese është deklaruar 100%. Ndërsa në deklaratën për vitin 2014, subjekti ka deklaruar vetëm blerjen dhe çmimin e automjetit, por jo burimin e të ardhurave të përdorura. Në parashtrimet e paraqitura gjatë gjykimit të çështjes në Kolegj, subjekti shpjegoi se si burim të ardhurash për financimin e këtij automjeti, në maj të vitit 2014, kanë shërbyer jo vetëm të ardhurat e periudhës janar – maj 2014, por edhe kursimet gjendje në *cash* që ajo dispononte në fund të vitit 2014. Përdorimi i këtyre të ardhurave ka passjellë deklaratën prej saj në deklaratën *vetting* se si burim financimi kanë shërbyer kursimet familjare, që përfshin edhe kursimet *cash* të disponuara deri në atë moment.

20.4. Trupi gjykues i Kolegjit, në reflektim të konkluzioneve sa më sipër, konkretisht: (i) të korrektimit të të dhënave të analizës financiare të periudhës deri në maj të vitit 2014 që kanë të bëjë me shumat e dhurimeve të vajzave; si dhe (ii) të ndryshimit të shpenzimeve të udhëtimeve, e pranoi si të besueshëm pretendimin e subjektit për përdorimin e një pjese të kursimeve cash që ajo dispononte në fund të vitit 2013 – të përllogaritura në masën 546.809 lekë për blerjen e automjetit në majin e vitit në vijim. Nga sa më sipër, trupi gjykues konstatoi se përfshirja e kursimeve cash si burim financimi për blerjen e këtij automjeti, korrekton rezultatin negativ të analizës financiare të Komisionit duke justifikuar blerjen e automjetit me burime të ligjshme.

II. Shqyrtimi i shkaqeve të ankimit lidhur me vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale

21. Komisionerja Publike, përpos sa përmbledhur e arsyetuar më sipër për vlerësimin e kriterit të pasurisë, ka ngritur shkaqe ankimi për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit. Në konkluzion, Komisionerja Publike argumenton për rrethana të cilat duhen çmuar nga Kolegji nën dritën e nenit 4, pika 2 të ligjit nr. 84/2016, sipas parashikimeve të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Sikurse referuar në detaj më sipër, në paragrafin nr. 7 e nënpjesët e tij në këtë vendim, pretendimet e Komisioneres Publike lidhen me çështjet e ndjekura nga subjekti i rivlerësimit që kanë të bëjnë: (i) me procedimin penal nr. {***/2010, me kallëzues A. R.; (ii) me denoncimin e znj. F. Y., që ka të bëjë me procedimin penal nr. {***/2019; (iii) me denoncimin e disa individëve të familjes H., që ka të bëjë me procedimin penal nr. {***/2014; (iv) me denoncimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit dhe Pastrimit të Parave, që ka të bëjë me procedimin penal nr. {***/2019.

21.1. Pas analizës së akteve në fashikull dhe shpjegimeve të subjektit nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, trupi gjykues vlerësoi se disa mangësi të evidentuara janë të pamjaftueshme për të konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë. Arsyetimi mbi të cilin bazohet ky konkluzion shtjellohet në vijim.

21.2. Çështja e parë parashtruar për analizë është procedimi penal nr. {***/2010⁴⁵, me kallëzues A. R.. Komisionerja Publike pretendon se: (i) *mungesa e kryerjes* së veprimeve hetimore shtesë, nuk është pa ndikim në ecurinë e çështjes penale, në aspektin procedural kohor dhe në atë material të së drejtës së kallëzuesit. Dokumenti që pretendohet se ishte falsifikuar po përdorej nga znj. N. U. në një proces tjetër gjyqësor civil dhe po ky akt ishte depozituar dhe pranë organeve tatimore; (ii) Komisioni duhet të kishte analizuar në mënyrë më të detajuar dhe cilësinë e analizës dhe argumentimit logjik të subjektit të rivlerësimit, mbi ndryshimin e cilësimit juridik të veprës së kallëzuar në ngarkim të së kallëzuarës, nga falsifikim i dokumenteve në shpërdorim detyre, për noteren [znj. F. Sh.] në momentin e vendimit të pushimit të saj. Këto aspekte duhen parë në drejtim të përgjegjësisë së personave të përfshirë në këtë veprë, rrethanat kohore kur këta persona e kanë përdorur këtë dokument, në raport dhe me efektin procedural të parashkrimit të këtyre veprave penale; (iii) ndër të tjera, nga aktet e administruara në dosje të Komisionit, rezulton se e kallëzuara për falsifikim dokumentesh, znj. N. U., administratore e shoqërisë “{***}”, në janar të vitit 2010 ka lidhur

⁴⁵ Për procedimin penal nr. {***}, të vitit 2010, me kallëzues A. R., Komisionerja Publike, ndryshe nga sa konkluduar prej Komisionit, vlerëson se në analizë të rastit të paraqitur me Gjetjen e Vëzhguesit Ndërkombëtar, e cila përbën provë në këtë proces, dhe në gjendjen që janë aktet në dosje, rezultojnë disa rrethana që duket se afektojnë kriterin e aftësisë profesionale, sipas nën-indikatorëve të parashikuar prej nenit 73, pika 2 dhe 3, si dhe nenit 75, pika 4, të ligjit nr. 96/2016.

kontratë shitblerje pasurie të paluajtshme⁴⁶ me nënën e subjektit dhe titullarët e tjerë të pasurisë, me objekt shitjen e truallit në një vlerë totale prej 502.500 euro. Të ardhurat nga kjo kontratë janë deklaruar nga subjekti si burim për krijimin e pasurive të saj.

21.2.1. Gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj subjekti i rivlerësimit, fillimisht evidentoi faktin se kjo çështje ka qenë pjesë e Raportit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, në rubrikën e të dhënave arkivore dhe që në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni nuk i ka kërkuar subjektit shpjegime dhe as e ka ngarkuar me barrë prove. Gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, për këtë procedim penal ajo argumentoi sa vijon:

- Mbi bazën e kallëzimit të shtetasit A. Rr. ka regjistruar procedimin penal nr. {***}, datë 26.07.2010, aktet e të cilit bëjnë fjalë për veprën penale të “Falsifikimit të dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal.
- Kallëzuesi parashtron se në datën 31.12.2004 ka nënshkruar një kontratë noteriale qiraje, para noteres F. Sh.. Kallëzuesi ka qenë në cilësinë e qiramarrësit, si Drejtor Ekzekutiv i Qendrës Shëndetësore për mbrojtjen e individit “{***}”. Në cilësinë e qiradhënëses ishte znj. N. U., administratore e shoqërisë “{***}” ShPK. Kontrata kishte për objekt një sipërfaqe prej 106 m², në Tiranë, me qira mujore 200 USD. Kallëzuesi nuk ka paraqitur kontratën me çmimin e pretenduar.
- Kallëzuesi pretendon se e kallëzuara ka falsifikuar këtë kontratë qiraje dhe është paraqitur në një proces gjyqësor civil që po zhvillohej në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Sipas kallëzuesit, në tre faqet e para të kontratës është falsifikuar nënshkrimi i tij. Vetëm në faqen e fundit nënshkrimi është i tij origjinal; edhe vlera e qirasë, nga 200 USD, ishte ndryshuar në 900 USD në muaj.
- Pasi janë kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore, pyetja e personave që kanë dijeni për rrethanat e hetimit, janë sekuestruar aktet noteriale të dyshuara si të falsifikuara dhe është administruar akti ekspertimit grafik etj., në datën 05.02.2011, subjekti ka vendosur pushimin e hetimeve të çështjes penale të nisur, pasi ka konstatuar se noterja ka konsumuar elemente të veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës”, por ndjekja penale nuk mund të vijonte për shkak të afateve të parashkrimit të ndjekjes penale, sipas nenit 66 të Kodit Penal. Arsyet janë parashtruar hollësisht në vendim.

21.2.2. Në parashtrimet e paraqitura në Kolegj subjekti shpjegoi edhe që përkundër sa parashtron Komisionerja Publike, në vendimin e pushimit të hetimeve të çështjes penale është pasqyruar se dokumenti është përdorur në gjykimin civil dhe, siç është provuar e më pas, nuk është paraqitur në organet tatimore. Gjithsesi, edhe nëse do të ishte paraqitur, në mungesë të dijenisë së saj që dokumenti ishte i falsifikuar, sërish nuk plotësoheshin elementet e figurës së veprës penale të përdorimit të dokumentit të falsifikuar. Ndryshe, nga sa parashtron Komisioneri Publik në ankim, kallëzuesit nuk i është cenuar asnjë e drejtë në aspektin material të së drejtës së tij. Vijimësia e procesit penal nuk ka lidhje me vijimësinë e procesit civil, pasi nëse kallëzuesi pretendon se kontrata e qirasë është e falsifikuar, nuk e pengon atë të kërkojë goditjen për falsitet në gjykimin civil, sipas dispozitave procedurale civile, pasi falsiteti i dokumentit është konfirmuar edhe me vendimin e pushimit të çështjes nga organi i prokurorisë.

⁴⁶ Kontrata nr. {***} rep./{***} kol., datë 14.01.2010, nëpërmjet të cilës znj. N. U., ka lidhur kontratë me trashëgimtarët e Dr. S. S., edhe me nënën e subjektit, si një ndër 48 bashkëpronarët, për shitblerjen e një trualli me sip. 670 m² dhe objektit brenda tij me sip. 181 m².

21.2.3. Subjekti gjithashtu shpjegoi se në asnjë moment gjatë ecursisë së hetimeve paraprahe të procedimit penal në fjalë nuk ka pasur dijeni⁴⁷ për kontratën e shitjes të pasurisë së paluajtshme, midis N. U. e tre blerësve të tjerë, dhe 48 bashkëpronarëve të një pasurie, ndër të cilët edhe nëna e saj, si bashkëpronare me 240/5760 pjesë të pronës. Subjekti specifikoi se për ekzistencën e kësaj kontrate ka ardhur në dijeni në periudhën kur ky procedim penal ishte kthyer për hetime të mëtejshme nga Gjykata e Apelit Tiranë dhe menjëherë ka vënë në dijeni Drejtuesin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë për t'ia kaluar vijimin e hetimeve një prokurori tjetër të kësaj prokurorie.

21.2.4. Pasi mori në analizë aktet e administruara për procedimin penal në fjalë, në fashikullin e Komisionit, trupi gjykues i Kolegjit konstatoi se:

(i) Më datë 05.02.2011, subjekti i rivlerësimit ka nxjerrë vendimin “Për pushimin e hetimeve të çështjes penale nr. {***} vitit 2010⁴⁸”.

(ii) Pas riçeljes së tretë të hetimeve, prokurori tjetër i ngarkuar për ndjekjen e çështjes, me vendimin e datës 17.04.2014, ka vendosur:

- Të pushojë procedimin penal nr. {***} të vitit 2010;
- Të deklarojë të falsifikuar kontratën nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 31.12.2004 dhe asgjësimin e saj nga policia gjyqësore.

21.2.5. Nga aktet, trupi gjykues konstatoi se në vendimin e pushimit të procedimit penal, subjekti nuk ka vendosur të deklarojë të falsifikuar kontratën noteriale të qirasë dhe asgjësimin nga policia gjyqësore, për të cilën gjatë hetimit penal ishte provuar nga raporti i policisë shkencore se ishte i falsifikuar. Nga hetimet për këtë procedim penal rezulton po ashtu se ndonëse OPGj-ja i ngarkuar ka marrë deklarin nga një individ [z. D. Z.] se “kjo kontratë i është paraqitur në zyrën e tij nga N. U. e cila në mungesë të A. R., i ka kërkuar ta firmosë D. pasi i duhet ekonomistes”, subjekti nuk ka kryer asnjë hetim në vijim të këtij deklarimi, për të konfirmuar vërtetësinë e tij, e për të verifikuar rolin aktiv të pretenduar të kryer nga e kallëzuara, në firmosjen e kësaj kontrate nga e cila ajo do të përfitonte të ardhura më të larta qiraje. Trupi gjykues, ashtu si edhe Komisionerja Publike, çmon se nga analizimi i vendimit të pushtimit të hetimeve të çështjes penale objekt analize, dinamika e zhvillimit të ngjarjeve, tregon se subjekti të duhet të kishte identifikuar palën që kishte kryer falsifikimin

⁴⁷ Referuar përgjigjes së Credins Bank ndaj kërkesës së subjektit të rivlerësimit, rezulton se pagesat për këtë kontratë janë bërë me çek bankar, nga shoqëria “{***}”, ku shtetasja N. U. është administratore.

⁴⁸ Në vendimin e pushimit të hetimeve të çështjes subjekti ka arsyetuar se: [...] që shtetasja N. U. të mbajë përgjegjësi për veprën penale “Falsifikim i dokumenteve” duhet domosdoshmërisht që dokumenti “kontratë qiraje” të jetë falsifikuar prej saj apo të jetë përdorur prej saj në dijeni të faktit që është i falsifikuar. Por ky dokument është nënshkruar nga notere F. Sh. dhe është legalizuar prej saj, gjithashtu është i regjistruar në regjistrin e veprimeve noteriale të kësaj notereje. Fakti që kontrata është nënshkruar dhe legalizuar nga noterja (bazuar dhe në aktin e ekspektimit tekniko-grafik) e bën këtë dokument të rregullt për palët. Në këto kushte, konstatoj se prej Notere F. Sh. janë konsumuar elementet e veprës penale “shpërdorim i detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, pasi me veprimet e saj e ka bërë të vlefshëm këtë dokument të falsifikuar, [...] për të cilën parashikohet dënimi me burgim deri në 7 vjet dhe me gjobë nga 300.000 deri në 1.000.000 lekë. Në kushtet kur kontrata e qirasë është legalizuar më datë 31.012.2004, dhe bazuar në nenin 3/3 të Kodit Penal, do të zbatohet dënimi i përcaktuar në ligjin nr. 9275, datë 16.09.2004, që është 6 muaj deri në 5 vjet dhe me gjobë me gjobë nga 300.000 deri në 1.000.000 lekë. Bazuar në nenin 66/c të Kodit Penal, kjo veprë penale është parashikuar pasi nuk mund të kryhet ndjekje penale kur nga kryerja e veprës (31.12.2004) deri në çastin e marrjes së personit si të pandehur kanë kaluar 5 vjet për krimet që parashikojnë dënimi deri në 5 vjet me gjobë”.

e kontratës. Noterizimi i saj më pas, me të drejtë, mund të konsiderohej si shpërdorim detyre nga noterja, sipas nenit 248 të Kodit Penal.

21.2.6. Në këto kushte, trupi gjykues çmon se pretendimi i Komisioneres është i bazuar. Subjekti nuk ka realizuar veprimet hetimore shtesë dhe kryerjen e një analize më të detajuar për efekt të ndryshimit të cilësimit juridik të veprës së kallëzuar, nga falsifikim i dokumenteve, kundrejt të kallëzuarës, në shpërdorim detyre, për noteren. Ky konstatim u bë pjesë e vlerësimit tërësor të Kolegjit, sipas parashikimeve të nenit 4, pika 2 të ligjit nr. 84/2016.

21.3. Çështja e dytë, e parashtruar për analizë në pretendimet e Komisioneres Publike lidhet me denoncimin e *znj. F. Y.*, për sa i përket procedimit penal nr. {***}/2019, për veprat penale “dhunimi i banesës” dhe “Falsifikim i dokumenteve” të parashikuar respektivisht nga neni 186 dhe neni 112 i Kodit Penal. Komisionerja Publike pretendon se subjekti nuk ka dhënë shpjegime bindëse mbi mungesën e veprimeve hetimore dhe drejtimin e duhur të tyre, konfirmuar kjo edhe nga kontrolli gjyqësor. Komisionerja Publike pretendon se problematikat e konstatuara, në rastin konkret, janë të vlefshme për t’u trajtuar nga Kolegji, sipas kriterëve të vlerësimit të ligjit nr. 96/2016, eventualisht së bashku me gjetjet e tjera të shkaqeve të ankimit, nën frymën e nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

21.3.1. Në përfundim të analizës së kryer për këtë procedim/denoncim, Komisioni ka konkluduar se subjekti nuk ka dhënë shpjegime mbi arsyet e kthimit të akteve nga Gjykata dhe vazhdimin e mëtejshëm të hetimeve, duke u shprehur vetëm për faktin se kjo çështje është ende në shqyrtim nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Sa i përket regjistrimit të materialit kallëzues, Komisioni ka konstatuar se subjekti arriti të provojë përmes akteve se regjistrimi i procedimit penal është kryer brenda një afati të arsyeshëm ligjor.

21.3.2. Nga aktet në fashikull rezulton se denoncuesja pretendon se: (i) subjekti i rivlerësimit, *znj. Suela Salavaçi* është në marrëdhënie direkte me shtetasin A. P., të cilin denoncuesja e ka kallëzuar për dhunim banese, vjedhje me anë të mashtrimit dhe falsifikim dokumentesh, për të cilën ka vendosur mosfillimin e procedimit; (ii) sipas denoncueses, procedimi penal është mbajtur pa regjistruar 1 vit e 2 muaj e më vonë për të është vendosur mosfillimi. Denoncuesja shprehet se subjekti është në kontakt të vazhdueshëm me persona të kallëzuar dhe persona me precedentë penal si A. P., A. B., B. D., etj.

21.3.3. Gjatë gjykimit të çështjes në Kolegj, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se:

- *Së pari*, pretendimet e denoncueses janë haptazi të pabazuara e dashakeqe, në kushtet që parashtron se procedimi penal është mbajtur pa regjistruar 1 vit e 2 muaj, pastaj është vendosur mosfillimi. Nga aktet rezulton se ky material kallëzues është regjistruar më datë 28.06.2019, me numër kallëzimi {***}, është caktuar nëpërmjet procedurës së shortit manual nga Drejtuesi i Seksionit më datë 28.06.2019, më pas më datë 02.07.2019 subjekti ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal [me numrin {***}]. Ky kallëzim penal është regjistruar vetëm 4 ditë pas regjistrimit dhe shortimit të tij. Nuk është vendosur asnjëherë mosfillimi i hetimeve për këtë material kallëzues.
- *Së dyti*, referuar akteve të dosjes dhe vendimit të gjykatës për kthimin e akteve për rihetim, për administrimin e dokumentacionit nga OShEE-ja, rezulton se në veprimet hetimore të kryera prej saj janë administruar këto akte dhe është pranuar nga vetë shtetasi (pasqyruar

ne vendim), në lidhje me paraqitjen e kontratës së shitjes që është deklaruar e falsifikuar me vendim gjykate. Është provuar se personi për të cilin ankohet kallëzuesja nuk ka pasur dijeni për to. Pa paragjykuar vendimin e gjykatës, në hetimet paraprake janë administruar akte shkresore që provojnë faktin, për të cilin, sipas gjykatës duhet të administrohet e gjithë dosja e OSSHE-se. Administrimi i dosjes së plotë të OShSEE-së, si i vetmi veprim hetimor që ka lënë detyrë gjykata, nuk sjell elementë të reja në lidhje me dijeninë apo jo të personit të kallëzuar për aktin e falsifikuar.

21.3.4. Nga aktet e administruara në fashikullin e Komisionit, lidhur me procedimin që referon ky denoncim rezulton se:

(i) Me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë [nr. {***}], datë 13.05.2013, është deklaruar e falsifikuar kontrata e shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. {***}, datë 07.05.2012, nga shtetasja A. B. dhe palë blerëse P. L.; me vendimin e po kësaj gjykate [nr. {***}], datë 04.05.2015, është shpallur absolutisht e pavlefshme kontrata e shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 10.02.2006, te blerësi D. B..

(ii) Vetë përshkrimi kronologjik i ngjarjeve që subjekti bën në kërkesën e saj për “pushimin e çështjes penale”, evidenton se P. L. më datë 19.11.2018 (*periudhë në të cilën ka qenë në dijeni të plotë të vendimit të gjykatës nr. {***}, datë 13.05.2013 me të cilin është bërë deklarimi i falsifikuar i kontratës së shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. {***} datë 07.05.2012, nga shtetasja A. B. dhe palë blerëse P. L.*), këtë kontratë e ka paraqitur në zyrat e OShEE për lidhjen e energjisë elektrike në pasurinë objekt konflikti. Në këtë kuptim, veprimi i P. L. për depozitimin prej tij në zyrat e OShEE-së, të akteve për të cilat ai ka dijeni se janë deklaruar si të falsifikuara me vendim gjykate, në kuptim të përcaktimeve të nenit 186 të Kodit Penal, duket se nuk justifikon kërkesën e subjektit për pushimin e çështjes penale.

(iii) Për sa i përket pretendimit të denoncueses se ky procedim penal është mbajtur pa u regjistruar nga subjekti i rivlerësimit për 1 vit e 2 muaj, e më vonë për të është vendosur mosfillimi, nga aktet bashkëlidhur denoncimit por edhe nga ato të sjella nga subjekti me shpjegimet për rezultatet e hetimit, evidentohet se kallëzimi i paraqitur nga denoncuesja ne Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, mban datën 11.06.2019, ndërsa urdhri i hartuar nga subjekti i rivlerësimit “Për regjistrimin e procedimit penal” mbi bazën e këtij kallëzimi është i datës 02.07.2019. Nga këto të dhëna nuk rezulton e provuar mbajtja e çështjes pa u regjistruar, për kohëzgjatjen e pretenduar prej “një vit e dy muaj”.

21.3.5. Për sa evidentuar më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se pretendimi i Komisioneres Publike, se ka problematika në shqyrtimin e kësaj çështjeje nga subjekti është një konstatim pjesërisht i drejtë, i cili do të mbahet në konsideratë në vlerësimin tërësor, nën frymën e nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

21.4. Çështja e tretë e parashtruar nga Komisionerja Publike lidhet me denoncimin e disa pjesëtareve të familjes H., që ka të bëjë me procedimin penal nr. {***}/2014 për veprën penale “Shpërdorim detyre” të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Komisionerja Publike argumenton se subjekti ka treguar mungesë të aftësisë për të kryer me efekt procedura hetimore dhe procedura të tjera të tjera të sistemit të Prokurorisë, brenda afateve të përcaktuara, të mbledhjes së provave të nevojshme, duke përfshirë dhe mungesën e mbikëqyrjes së dërgimit pa vonesë të akteve të nevojshme të njoftimit, referuar indikatorëve

të përcaktuar nga neni 73/2 dhe 3, si dhe neni 74/4 i ligjit nr. 96/2016, të cilin e analizon sa vijon:

21.4.1. Në përfundim, Komisioni ka vlerësuar se subjekti shpjegoi veprimet e kryera prej saj, në zbatim të vendimeve gjyqësore, si dhe arsyen e vonës së veprimeve hetimore tej afatit të caktuar nga gjykata. Ajo dha shpjegime mbi arsyet që kanë çuar në kthimin e çështjes nga gjykata për hetime të mëtejshme. Nisur nga fakti se Gjykata e Apelit Tiranë ka pranuar vendimin e subjektit për pushimin e çështjes, mbetet i paqartë kthimi i akteve nga gjykata në mënyrë të përsëritur. Komisioni ka çmuar të referojë çështjen pranë organit kompetent, ILD, për të vlerësuar nëse ka shkaqe për hetim disiplinor lidhur me kallëzimin e regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

21.4.2. Subjekti i rivlerësimit në parashtrimet e paraqitura në Kolegj, ka shpjeguar se:

- Procedimi penal nr. {***} është regjistruar në datën 11.02.2014 për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës” dhe është ndjekur fillimisht nga dy prokurorë të tjerë, deri në datën 15.09.2015, kur dosja hetimore i është ngarkuar për të vijuar hetimet.
- Më datë 26.10.2015, subjekti ka vendosur pushimin e procedimit penal duke arsyetuar se veprimet apo mosveprimet e punonjësve të Bashkisë së Tiranës nuk përmbajnë elementet e veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës”.
- Ndonëse për këtë procedim gjykata ka kthyer aktet katër herë për hetime të mëtejshme, ajo ka kryer veprimet hetimore të kërkuara specifikisht, të cilat i ka shpjeguar në mënyrë të detajuar si në Komision ashtu edhe në Kolegj, duke u kujdesur për realizimin e tyre brenda afateve optimale.
- Me vendimin nr. {***}, datë 21.04.2021, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur: Ndryshimin e vendimit nr. {***} Regj. Them., datë 04.05.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Pranimin e kërkesës së Prokurorit. Pushimin e procedimit penal nr. {***} regjistruar, më datë 11.02.2014, për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës” parashikuar nga neni 248 i Kodi Penal. Ndaj këtij vendimi rezultoi të jetë ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë dhe kjo çështje është me status “në proces”.

21.4.3. Gjatë seancës gjyqësore të datës 25.09.2024, me parashtrimet subjekti depozitoi në Kolegj në cilësinë e provës edhe shkresën nr. {***} prot., datë 08.04.2024, të Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë (në vijim “ILD”), me anë të së cilës ajo njoftojë për arkivimin pas verifikimit të ankesës së bërë nga katër denoncuesit e familjes H., në ngarkim të saj lidhur me procedimin penal në fjalë. Në këto rrethana subjekti theksoi se ILD nuk ka konstatuar të dhëna që të përbëjnë shkelje disiplinore, në kuptim të ligjit nr. 96/2016.

21.4.4. Pasi u njoh me sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit e vlerësoi të panevojshëm të investohet me analizimin e denoncimit të paraqitur nga këta denoncues. Në kushtet që organi kompetent i juridiksionit të zakonshëm që, sipas nenit 147/d i Kushtetutës, pas hetimit të kryer për pretendimet e adresuara në ankim për ankesën e Familjes H. etj, ka konkluduar për arkivimin e saj, trupi gjykues i Kolegjit e vlerëson të trajtuar ankimin dhe pa peshë në vlerësimin profesional të subjektit për efekt të procesit të rivlerësimit, në analizë të gjithë rrethanave të sipërreferuara.

21.5. Çështja e fundit e parashtruar në ankim, lidhet me denoncimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit dhe Pastrimit të Parave (në vijim, DPPP), që ka të bëjë me procedimin penal nr. {***}/2019. Komisionerja Publike kërkon ky denoncim të vlerësohet

nga Kolegji, së bashku me gjetjet e tjera, në kuptim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016., meqenëse në fashikullin e Komisionit nuk ka akte të administruara lidhur me të.

21.5.1. Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e saj të paraqitura në Kolegji shpjegoi se mbi bazën e kallëzimit të këtij institucioni dhe pretendimeve të sipërcituara, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë ka regjistruar kallëzimin penal nr. {***} të vitit 2022 dhe me vendimin të datës 01.12.2022 është vendosur mosfillimi i procedimit penal, pasi është konkluduar se nga subjekti, në cilësinë e prokurores së çështjes, ka vepruar në përputhje me ligjin procedural penal, e konkretisht nenin 208 të Kodit të Procedurës Penale. Nga veprimet verifikuese hetimore nuk ka rezultuar që subjekti/prokuroerja të ketë zbuluar informacione origjinale të klasifikuara nga një institucion tjetër pa autorizim të këtij të fundit. Ky vendim për mosfillimin e procedimit penal i është njoftuar kallëzuesit, DPPP-së. Ky institucion, duke mos qenë dakord ka ushtruar ankim në gjykatë. Pas shqyrtimit të ankimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur [me vendimin nr. {***} Regj. Them.] datë 23.01.2023 mospranimin e ankimit, duke konkluduar se ai [ankimi i DPPP-së] është *i pabazuar* në fakte e ligj. Me këtë vendim gjyqësor duket se është dakordësuar edhe kallëzuesi, pasi nuk rezulton të ketë ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Vendimi i mësipërm i gjykatës ka marrë formë të prerë në datën 23.02.2023.

21.5.2. Subjekti evidentoi edhe që me anë të shkresës nr. {***}prot., datë 29.03.2024⁴⁹, është njoftuar nga ILD-ja se ky organ, në ushtrim të kompetencave të tij kushtetuese dhe ligjore, ka marrë vendimin për arkivimin pas verifikimit të ankesës së paraqitur nga DPPP-ja, pasi nga hetimi i kryer nuk ka dyshime për të filluar hetimin disiplinor, duke informuar Kolegjin se ky hetim nga ILD-ja është kryer pas paraqitjes së ankimit nga Komisionerja Publike.

21.5.3. Në këto kushte, me të njëjtin arsyetim të dhënë për denoncimin e familjes H., edhe në këtë rast, trupi gjykues i Kolegjit e vlerësoi të panevojshëm të investohet me analizimin e denoncimit të paraqitur nga DPPP-ja, për sa kohë pas publikimit të ankimit të Komisioneres Publike për pretendimet e adresuara në ankim lidhur me të ka kryer hetim dhe ka konkluduar për arkivimin e ankesës.

21.6. Në përfundim të vlerësimit të kryer për këtë kërkim, trupi gjykues i Kolegjit konstatoi disa mangësi në trajtimin e dy çështjeve të analizuara në këtë rubrikë, lidhur me kriterin e vlerësimit profesional të subjektit, që lidhen me nënindiktorët e përcaktuar në nenin 73, paragrafi 2 i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Në vijim të arsyesimit të mësipërm, mangësitë e konstatuara në çështjen që lidhet me denoncimin e z. A. Rr. dhe atë që lidhet me denoncimin e znj. F. Y., janë të pamjaftueshme e të një natyre që do të duhet të passillnin pasojë në kriterin e aftësive profesionale të subjektit.

22. Në përfundim e në përmbledhje të sa më sipër, nën dritën e konkluzioneve të mësipërme dhe atyre të arritura nga Komisioni, për kriterin e kontrollit të figurës e kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, trupi gjykues i Kolegjit çmon se vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 703, datë 28.09.2023, i cili ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Suela Salavaçi, është marrë në vlerësim të drejtë të fakteve e provave të

⁴⁹ Ky vendim është depozituar në Kolegji nga subjekti me parashtrimet e seancës gjyqësore të datës 25.09.2024.

administruara gjatë hetimit e në zbatim të drejtë të dispozitave ligjore që rregullojnë procesin e rivlerësimit dhe, si i tillë, duhet të qëndrojë në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupit gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 703, datë 28.09.2023, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Suela Salavaçi.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe me efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, më datë 22.10.2024.

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi-kundër

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

RELATORE

Ina RAMA

nënshkrimi-kundër

KRYESUESE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

MENDIM PAKICE

1. Ne, gjyqtarët Ina Rama dhe Sokol Çomo, kemi votuar kundër vendimit të dhënë nga shumica e trupit gjykues, për lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që ka konfirmuar në detyrë subjektin e rivlerësimit, znj. Suela Salavaçi, duke votuar për ndryshimin e tij dhe shkarkimin nga detyra të subjektit.
2. Vota jonë kundër vendimit të marrë nga shumica e trupit gjykues lidhet me qëndrimin ndryshe në drejtim të disa shkaqeve të ankimit të ngritura në ankimin e Komisioneres Publike Irena Nino, të cilat të vlerësuara sipas analizës tonë çojnë drejt konkluzionit se subjekti i rivlerësimit është në kushte të mungesës së burimeve të ligjshme për të justifikuar pasuritë në pronësi të saj, si edhe për të përballuar shpenzimet e jetesës, në vlera të konsiderueshme të larta, duke mos arritur një nivel të besueshëm lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, në kuptim të nenit D, pika 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës e, për pasojë, të gjendet në kushte të një deklarimi të pamjaftueshëm në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronja “b” dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.
3. Analiza e mëposhtme në mbështetje të votës tonë kundër do të fokusohet në ato çështje për të cilat kemi ndarë qëndrime të ndryshme nga shumica, të cilat kanë përcaktuar edhe votën tonë për ndryshimin e vendimit të Komisionit.
4. Çështja e parë, e marrë në analizë, i përket shqyrtimit të shkakut të ankimit të ngritur nga Komisionerja Publike, lidhur me kufijtë e analizës financiare mbi pasuritë e prindërve të subjektit, nëse ajo do të shtrihet mbi të gjitha pasuritë e tyre apo vetëm mbi pasuritë e dhuruara subjektit, në konsideratë të interpretimit që Kolegji i ka bërë nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, në jurisprudencën e tij.

Komisionerja Publike e ka mbështetur këtë pretendim të saj, mbi pikat 1, 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, duke synuar nëpërmjet këtij referimi përjashtimin e çdo dyshimi se pasuritë, të cilat *de jure* i janë dhuruar subjektit prej prindërve, të jenë krijuar prej asaj, duke qenë për pasojë pasuri të fshehura të subjektit. Komisionerja Publike, në ankim, nuk ka adresuar çështjet mbi një pasuri të caktuar, por mbështetur në faktin se pothuaj të gjitha pasuritë e prindërve i kanë kaluar subjektit të rivlerësimit në pronësi në një mënyrë apo tjetrën, ajo ka ngritur dyshime se secila prej tyre, potencialisht mund të jetë një pasuri e fshehur e subjektit. Për këtë arsye, Komisionerja Publike ka pretenduar se prindërit e subjektit duhej t'i nënshtroheshin kontrollit të burimeve të ligjshme, lidhur me nenin 32, pika 4 e ligjit 84/2016, që jurisprudenca e Kolegjit ka vendosur për analizimin e personave të tjerë të lidhur, pasi, mbështetur në orientimin që ka dhënë po jurisprudenca e Kolegjit, këto kufij mund të mosrespektohen kur ka dyshime për pasuri të fshehura.

4.1. Shkaku i mësipërm ankimor është mbështetur në situatën faktike, që disa nga pasuritë në pronësi të subjektit të rivlerësimit të deklaruar në deklaratën *vetting* kanë si burim krijimi të ardhura të prindërve. Këto pasuri evidentohet se janë si më poshtë.

i. *Apartament me sip. 121,36 m², rruga “{***}”, Tiranë (Rruga e {***})*

Në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar se kjo pasuri është porositur dhe likuiduar nga nëna e saj, sipas kontratës së porosisë, datë 10.03.2005, në vlerën 38.800 USD, e finalizuar nga subjekti me kontratën e shitblerjes nr. {***} rep., e nr. {***} kol., datë 20.11.2013 dhe deklaratën noteriale nr. {***} rep., e nr. {***} kol., datë 02.11.2013, nëpërmjet të cilës nëna e subjektit ka hequr dorë nga pronësia e apartamentit, duke ia dhuruar vajzës Suela Salavaçi. Në deklaratën periodike vjetore (në vijim DPV) të vitit 2013, subjekti ka deklaruar: “*Apartament me vlerë 38.800 USD*”, pa deklaruar burimin e krijimit.

ii. *Apartament me sipërfaqe 84 m², në Golem*

Në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar se apartamenti është porositur nga babai i saj, sipas deklaratës noteriale datë 08.02.2005 dhe kontratës së porosisë, datë 08.10.2010, pasuri kjo ende e

paregjistruar. Objekti i kësaj kontrate është ndërtimi i një apartamenti 2+1, me sipërfaqe të përgjithshme 90,5 m², në katin e {***} të banimit, në Golem, Kavajë, kundrejt çmimit 72.000 euro. Për këtë pasuri, në DVP-2012, në seksionin e deklarimit të ndryshimit të pasurive, subjekti ka deklaruar: “Kontratë porosie apartamenti 2+1; vlera: 72.000 euro; pjesa takuese: 100%, pa deklaruar burimin e krijimit”.

iii. *Banesë dhe truall në rrugën “{***}” Tiranë*

Në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar si adresë banimi rrugën “{***}”, Tiranë, në pronësi të babait, e formalizuar me deklaratën noteriale nr. {***} rep., e nr. {***} kol., datë 25.10.2016. Referuar kësaj deklarate noteriale, babai i subjektit P. S., ndër të tjera, deklaroi se vajza së bashku me familjen e saj jetojnë prej vitit 1998 në banesën e tij (truall dhe objekt 2-katësh në rrugën “{***}”), pashpërblim. Kjo pasuri, me anë të kontratës nr. {***} rep., e nr. {***} kol., datë 04.04.2017, i dhurohet subjektit të rivlerësimit nga prindërit e saj P. S. dhe L. S..

iv. *Gjendje cash në shumën 10.000 euro, me burim nga shitja e një pasurie të paluajshme*

Në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar se gjendja *cash* në shumën 10.000 euro ka si burim të ardhurat nga shitja e një pasurie të paluajshme me kontratën e premtim shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.08.2012, të lidhur ndërmjet shitësve trashëgimtarë të shtetasit K. K., midis së cilëve është edhe nëna e subjektit L. S. dhe blerësit shoqëria “{***}” ShPK.

v. *Depozitat dhe llogaritë bankare dyemërore bashkëmbajtëse të subjektit me prindërit*

Në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar se llogaria bankare është hapur nga prindërit e saj në datën 04.02.2005, pranë NBG-së, me gjendje në shumën 52.534 USD dhe në datën 17.12.2012 subjekti është bërë bashkëmbajtëse në këtë llogari dhe nuk ka kontribuar në hapjen e saj, ku gjendja e llogarisë në këtë datë, më 17.12.2012, ka qenë në shumën 63.504 USD.

Në DPV-në 2004, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Depozitë në shumën 52.000 USD, pjesa takuese 0 %; me përshkrimin, depozitë në emër të babait tim P. S.*”.

Në DPV-në 2012, në rubrikën “Të dhëna konfidenciale”, subjekti ka deklaruar: “*Mbajtëse e tretë llogarie në NBG Bank, me përshkrimin P. S. -Babai; L. S. (nëna). Llogaritë e vajzave të subjektit K. dhe K. M.*”.

vi. *Llogaritë bankare të vajzave të subjektit*

Në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar gjendjen e llogarisë në emër të vajzës K. M., në shumën 11.652 USD, pranë Intesa Sanpaolo Bank. Subjekti deklaroi se llogaria bankare e vajzës K. është hapur në vitin 2004, në shumën fillestare 2.000 USD nga nëna dhe shtesat ndër vite janë bërë po nga nëna. Intesa Sanpaolo Bank ka konfirmuar gjendjen e kësaj llogarie bankare. Gjithashtu, në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar gjendjen e llogarisë në emër të vajzës K. M. në shumën 6.462 USD pranë Credins Bank. Kjo llogari është hapur në vitin 2011 në shumën fillestare 1.000 USD nga nëna e subjektit dhe shtesat ndër vite janë bërë prej saj. Si burim krijimi janë deklaruar të ardhurat e familjes.

4.2. Nga aktet në fashikullin e Komisionit, rezulton se përveç pasurive të subjektit të listuara më sipër e të krijuara me të ardhurat e prindërve, prindërit e subjektit kanë disponuar ndër vite edhe pasuri të tjera, që kryesisht janë shuma parash/likuiditete të depozituara në llogari bankare. Në këtë kontekst, pretendimi i Komisioneres Publike synonte kontrollin e burimeve të prindërve për të financuar, jo vetëm pasuritë e dhuruara subjektit, por edhe për të financuar pasuritë e luajshme që ndodheshin në llogaritë e tyre bankare, veçanërisht në kushtet kur përfituese e pothuaj të gjitha pasurive të prindërve ka qenë subjekti i rivlerësimit në dallim nga vëllai i saj.

4.3. Pakica i është bashkuar qëndrimit të shumicës, sipas një version garantist, se nuk ekzistonin adresime të qarta prej Komisioneres Publike, në ankim, rreth dyshimeve për fshehje të pasurisë, për

sa kohë që pretendimi mbetet përgjithësues dhe nuk garantonte të drejtën e subjektit për ushtrimin e një mbrojtje efektive. Në këto kushte, ne gjyqtarët në pakicë, u dakordësuam që të kontrolloheshin mundësitë financiare të prindërve vetëm për pasuritë e dhuruara subjektit, sipas standardit të vendosur prej jurisprudencës së Kolegjit, lidhur me zbatimin e nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Sipas këtij qëndrimi, por mbështetur në një analizë financiare të ndërtuar sipas një metodologjie të ndryshme nga shumica, ne gjyqtarët në pakicë, konsideruam si të ardhura: (i) të gjitha të ardhurat prindërve të deklaruar prej subjektit si burim për krijimin e pasurive të dhuruara asaj; (ii) nuk u përfshinë te të ardhurat shuma e siguruar nga aktmarrëveshja e vitit 2003, për shkak se siç ka deklaruar subjekti ajo ka shërbyer për depozitimet/kreditime në *cash* të llogarive bankare të prindërve, të cilat ekzistojnë si gjendje prej vitit 2004 e deri në deklaratën *vetting*; (iii) nuk u përfshinë te të ardhurat pjesa trashëgimore e tezes së nënës së subjektit, me të njëjtin arsyetim si shumica. Në këtë analizë si shpenzime janë llogaritur shpenzimet për jetesë të prindërve dhe ato të kryera për financimin e pasurive të dhuruara subjektit, duke përjashtuar tërësisht nga analiza likuiditetet e depozituara në sistemin bankar prej prindërve të saj në datën 31.12.2016, në vlerën totale prej 18.581.484 lekësh. Nga kjo analizë, rezultoi se prindërit e subjektit kishin mundësi të krijonin me të ardhura të ligjshme pasuritë e dhuruara subjektit deri në momentin e plotësimit të deklaratës *vetting*, duke pasur në këtë mënyrë të njëjtin konkluzion si shumica, ndonëse nëpërmjet një logjike të ndryshme kontrolli.

4.4. Në vijim të këtij qëndrimi, pakica konsideroi se, përveç sa më lart, kontrollit duhej t'i nënshtrohej edhe pasuria shtëpi banimi dhe truall, me vendndodhje në rrugën “{***}”, në Tiranë, e cila ishte deklaruar prej subjektit në deklaratën *vetting*, si adresa e banimit që prej vitit 1998, së bashku me gjithë familjen e krijuar prej saj, duke qenë në referim edhe të akteve të përcjella nga vetë subjekti, banesa e saj që prej krijimit/ndërtimit të objektit. Kjo pasuri rezultoi e deklaruar si e tillë në deklaratën *vetting*, në janar të vitit 2017, dhe vetëm tre muaj më pas, edhe ajo i është dhuruar subjektit prej prindërve, nëpërmjet kontratës së dhurimit nr. {***} rep., e nr. {***} kol., datë 04.04.2017.

4.5. Nga vendimi rezultoi se shumica ka përjashtuar tërësisht nga kontrolli këtë pasuri, në drejtim të verifikimit të ligjshmërisë së burimeve të prindërve për ta krijuar atë, me arsyetimin se ajo i është dhuruar subjektit pas plotësimit të deklaratës *vetting*, dhe se ajo është ndërtuar prej prindërve kur subjekti nuk ushtronte funksionin e prokurores⁵⁰. Duke përjashtuar këtë pasuri nga analiza, ka rezultuar se prindërit e subjektit, sipas shumicës, kishin mundësi të krijonin me burime të ligjshme të gjitha pasuritë e tjera të dhuruara asaj e të renditura më lart.

4.6. Ne, gjyqtarët në pakicë, kemi vlerësuar se kjo pasuri duhej t'i nënshtrohej kontrollit të burimeve të krijimit prej prindërve, ashtu si pasuritë e tjera të dhuruara subjektit, mbështetur në argumentet si më poshtë.

4.7. *Së pari*, kjo pasuri është një pasuri e deklaruar në deklaratën *vetting*, si një pasuri në përdorim të subjektit e, për më tepër, si banesa e saj dhe familjes. Bashkëlidhur deklaratës *vetting*, subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale nr. {***} rep., e nr. {***} kol., datë 25.10.2016, të babait të saj, në të cilën ai deklaroi se vajza së bashku me familjen e saj jetojnë prej vitit 1998 në banesën e tij, objekt 2-katësh dhe truall të ndodhur në rrugën “{***}”, në Tiranë, pashpërblim. Në këtë kontekst, kjo pasuri gëzon statusin e një pasurie në përdorim, që duhet t'i nënshtrohet kontrollit, sipas përcaktimit kushtetues të nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetues⁵¹, parashikimit të neneve 30⁵², 31, pika 1⁵³ dhe shtojcës nr. 2 të ligjit nr. 84/2016, në të cilën subjektet kanë detyrimin të deklarojnë përveç pasurive

⁵⁰ *Shih paragrafin 13.5 të vendimit të Kolegjit.*

⁵¹ *Subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklaratimit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur*

⁵² *Objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij.*

⁵³ *Subjekti i rivlerësimit plotëson deklaratën e pasurisë, sipas shtojcës 2 bashkëlidhur këtij ligji, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi dhe e dërgon pranë ILDKPKI-së.*

në pronësi edhe ato në përdorim. Këto parashikime ligjore janë interpretuar e zbatuar gjerësisht prej Kolegjit në jurisprudencën e tij në të njëjtën mënyrë⁵⁴, duke vendosur nën kontroll pasuritë në përdorim të subjekteve në disa drejtime, qoftë në drejtim të marrëdhënies së subjekteve në raport me to, qoftë në drejtim të kontrollit të burimeve për krijimin e tyre, sipas rrethanave të rastit.

4.8. Përtej argumentit ligjor si më sipërsyrtuar, ekzistojnë disa rrethana specifike që e bëjnë të domosdoshme kontrollin e kësaj pasurie, në këndvështrim të shkakut të ankimit se mund të gjendemi në kushtet e nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës. Kjo pasuri, një godinë prej dykatësh, me sipërfaqe totale ndërtimit prej 268 m² dhe truall 303,6 m² e ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, referuar vetëdeklarimeve të subjektit, ka qenë që nga krijimi/ndërtimi i saj në vitin 1998 banesa ku ajo dhe familja e saj ka jetuar së bashku me prindërit e, po ashtu, vijon të jetojë deri në zhvillimin e procesit të rivlerësimit. Banesa, sipas deklarimeve të subjektit, është ndërtuar fillimisht në vitet 1997-1998, por ka pësuar ndryshime strukturore të rëndësishme në vitet 2004, dhe 2010 dhe 2011, në ndryshim nga ajo që referon shumica në vendim se kjo pasuri është krijuar kur subjekti nuk ushtronte funksionin e prokurores. Ndërsa këto punime/investime kryheshin në këtë objekt, në të cilin banonte e gjithë familja e subjektit, për më tepër në një periudhë kohore në të cilën ajo ushtronte funksionin e prokurores, dhe gjendej në të njëjtën ekonomi familjare me prindërit, alternativa se i gjithë investimi kryhej vetëm prej prindërve, ndërsa subjekti ishte krejtësisht indiferente dhe nuk kishte asnjë kontribut, i cili, për më tepër, do të shkonte në çdo rast në përmirësimin e kushteve të jetesës për të dhe familjen e saj, duket i paarsyeshëm dhe i pabesueshëm. Në këtë kuptim, në vlerësimin e pakicës, burimet për krijimin e kësaj pasurie duheshin kontrolluar, në funksion të përgjigjes së shkakut të ankimit, për kontrollin e një pasurie në përdorim të subjektit.

4.9. Përveç sa më sipër, një element tjetër që na ka çuar drejt qëndrimit se kjo pasuri duhej t’i nënshtrohej kontrollit, lidhet me faktin se subjekti vetëm tre muaj pas dorëzimit të deklaratës *vetting* ka fituar pronësinë mbi këtë pasuri, me anë të një kontrate dhurimi prej prindërve. Ky fakt, i ndodhur shumë afër në kohë me dorëzimin e deklaratës *vetting*, për pasuri të krijuara gjatë periudhës së rivlerësimit, që siç u referua më sipër nga ku rezultoi se banesa ka pasur ndryshime të rëndësishme në këto vite, si dhe rritje të vlerës së saj, rrjedhimisht do të duhej të përcaktonte, edhe në abstragim të sa më lart, kontrollin si një pasuri për të cilën subjekti duhej të provonte burimet e ligjshme. Edhe në këtë drejtim, sjellim në vëmendje qëndrimet e mbajtura në jurisprudencën e Kolegjit, sipas së cilave lejohet kontrolli i pasurive të krijuara pas deklaratës *vetting*, në kushte specifike, kur duket se këto pasuri e kanë origjinën të lidhur në një mënyrë ose tjetrën me periudhën e rivlerësimit⁵⁵.

4.10. Për të gjitha sa u arsyetua më lart, pakica ka vlerësuar se objekti në rrugën “{***}, në Tiranë”, duhej t’i nënshtrohej kontrollit të burimeve të ligjshme të krijimit të tij, nëpërmjet kryerjes së një analize të fragmentuar në të cilën të përfshiheshin: (i) të gjitha të ardhurat e tjera të prindërve të subjektit të papërfshira në analizën për pasuritë e dhuruara subjektit, të cilat nuk janë deklaruar si burim për krijimin e tyre; (ii) shpenzimet për krijimin/ndërtimin e këtij objekti si dhe vlerat e disponuara në llogaritë bankare.

4.11. Sipas kësaj analize, pakica vlerësoi të konsiderojë si të ardhur të llogaritshme shumë prej 15.500.000 lekësh, të përfituar prej aktmarrëveshjes së lidhur në vitin 2003, mes nënës së subjektit dhe shoqërisë “{***}” ShPK, në një version garantist, duke abstraguuar për mungesën e plotësimit të kriterit të të ardhurës së ligjshme për këtë shumë, në kuptim të nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016, konsideruar se kjo shumë ishte përfituar në vitin 2003, për premtim shitje në të ardhmen të një pasurie që do të disponohej prej nënës së subjektit, ndonëse, deri në kohën e gjykimit të çështjes, në vitin 2024, kjo pasuri rezultoi se nuk disponohej ende nga nëna e subjektit dhe shitja e premtuar nuk ishte

⁵⁴ Shih vendimet e Kolegjit, në të cilat objekt kontrolli kanë qenë pasuritë në përdorim (JR) 9/2020; (JR) 26/2021; (JR) 21/2020; (JR) 48/2022; (JR) 10/2022; (JR) 11/2023; (JR) 46/2023; (JR) 36/2023, (JR) 20/2023; (JR) 52/2023; dhe (JR) 29/2024.

⁵⁵ Shih vendimet e Kolegjit: (JR) 8/2021; (JR) 36/2023 dhe (JR) 20/2023.

realizuar ende. Këto elemente na çojnë drejt konstatimit se në këtë mënyrë është shkaktuar një shmangie e rëndësishme nga detyrimet tatimore për një kohë shumë të gjatë, e mbi të gjitha një situatë pa të ardhme të sigurt në këtë drejtim, në rast se shitja nuk do të ndodhte asnjëherë.

4.12. Në këtë analizë, pakica vlerësoi të konsiderojë si të ardhur edhe vlerën e përfutur prej kredisë së marrë nga nëna e subjektit në vitin 2010, e cila ishte një kredi konsumatore dhe jo e përdorshme për financimin e pasurive të dhuruara, sipas deklarimeve të vetë subjektit për burimet e tyre. Krahas këtyre të ardhurave në këtë analizë u përfshinë si shpenzime vetëm ato të përdorura për krijimin e pasurisë në rrugën “{***}”, Tiranë dhe për krijimin e likuiditeteve bankare, duke sjellë në vëmendje se e gjithë shuma prej 15.500.000 lekësh është deklaruar prej subjektit se ka financuar kreditimet e depozitave/llogarive bankare, të cilat janë gjendje që nga koha e krijimit të tyre deri në deklaratën *vetting*, dhe nuk mund të përdoret si burim për krijimin e pasurive të tjera. Përdorimi i saj në analizën e bërë nga shumica, si një e ardhur e kalkulueshme është konsideruar prej pakicës si veprim thjeshtë matematikor, por që nuk mbështetet në situatën faktike, pasi kjo shumë gjendet e depozituar në sistemin bankar përgjatë gjithë periudhës, e palëvizur dhe padisponueshme prej prindërve për financime të tjera, për pasojë ajo nuk mund të përlllogaritet si e tillë në analizën financiare, por mund të përlllogaritet vetëm në funksion të krijimit të depozitave/llogarive bankare.

4.13. Mbështetur mbi këtë qëndrim, me ndihmën e Njësisë së Shërbimit Ligjor, u kontrollua vendimi i Komisionit, nga i cili rezultoi se prindërit e subjektit ishin në mungesë të burimeve të ligjshme për të justifikuar investimet në objektin në rrugën “{***}”, në Tiranë, në vitin 2011 dhe shtimin e gjendjes së likuiditeteve në sistemin bankar, në vlerën prej (-) 3.277.728 lekësh. Në këtë analizë evidentohet se nuk janë përfshirë kostot e mobilimit të pjesëve/sipërfaqeve të shtuara të objektit⁵⁶, të cilat padyshim për të qenë të banueshme kanë pasur nevojë për të. Për pasojë, subjekti gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

5. Çështja e dytë, për të cilën kemi ndarë një qëndrim të ndryshëm nga shumica e trupit gjykues, lidhet me shkakun e ankimit të Komisioneres Publike, sipas së cilit, *bazuar në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit, mbi vlerën provuese të deklaratave të interesave privatë ndër vite*⁵⁷, vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të likuiditetit në formën cash, pasi konstaton se: (i) subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar shumën 10.000 euro në DPV-në 2015, si likuiditet në formën cash (momentin e tërheqjes nga llogaria e saj, të shumës 14,500 euro); (ii) subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar as në DVP-në 2016 likuiditet në formën cash, në shumën 10.000 euro; si dhe (iii) as në DPV-në 2017 si likuiditet në formën cash apo si dhurim. Gjithashtu, Komisionerja Publike mbështet pretendimin e saj edhe mbi kundërshtitë/mospërputhjet e deklarimeve të subjekti lidhur me disponimin e kësaj shume, përgjatë hetimit administrativ në Komision.

5.1. Nga aktet në dosjen gjyqësore rezulton se subjekti ka deklaruar:

Në deklaratën *vetting*: “Gjendje cash në shtëpi si rezultat i shitjes së pasurisë së paluajtshme referuar kontratës datë 21.08.2012, nr. {***} rep., e nr. {***} kol. Referohu dokumentacionit bashkëlidhur deklaratës lidhur me burimin e krijimit”, në vlerën 10.000 euro, me pjesë takuese 100%.

Në DVP-në e vitit 2015: Në rubrikën “Ndryshimet e pasurive dhe burimi e krijimit” ka deklaruar: “Të ardhura nga kontrata nr. {***}, për shitjen e një prone në emër të nënës sime L. S., BKT, në vlerën 14.500 euro, me pjesë takuese 100%”.

⁵⁶ Në vendimin e Komisionit në paragrafin 26.7 evidentohet se: Gjatë hetimit, subjekti ka shpjeguar se vlera e blerjes së truallit është likuiduar me këste nga viti 1997 dhe i likuiduar përfundimisht në datën e lidhjes së kontratës. Sipas shpjegimeve të subjektit, mbi këtë pasuri ndodhet banesa private 2-katëshe e ndërtuar nga prindërit e saj, ku kati përdhe me sip. 125 m² është ndërtuar në vitet 1997 – 1998, ndërsa kati i parë, i cili është papafingo me sipërfaqe ndërtimi 143 m², është ndërtuar në vitet 2010 – 2011.

⁵⁷ Në ankim, Komisionerja Publike referon si jurisprudencë vendimet e Kolegjit: (JR) nr. 6/2018; (JR) nr. 8/2018; (JR) nr. 9/2018; (JR) nr. 11/2018; (JR) nr. 12/2018; (JR) nr. 5/2019; (JR) nr. 19/2019; (JR) nr. 20/2019; (JR) nr. 5/2020 dhe (JR) nr. 27/2020.

5.2. Nga dokumentacioni bankar i administruar në fashikullin e Komisionit, rezulton se shuma prej 14.500 eurosh e depozituar në Bankën Kombëtare Tregtare (në vijim “BKT”) në datën 10.04.2015, për llogari të kontratës së sipërcituar, është tërhequr prej kësaj llogari nga subjekti në datën 14.05.2015. Kjo shumë është deklaruar në DVP-në e këtij viti, si e ardhur në pronësi të subjektit 100% dhe jo si një gjendje *cash* e disponuar prej saj në fund të vitit. Në këtë aspekt, pakica ka vlerësuar se është i drejtë pretendimi i Komisioneres Publike, referuar jurisprudencës së konsoliduar të Kolegjit, se subjekti duke mos e deklaruar këtë shumë si gjendje *cash* në fund të vitit në të cilin e ka deklaruar si të ardhur, nuk mund të provojë me forma të tjera ekzistencën e saj si pasuri e krijuar në këtë vit. Rreth kësaj shume nuk gjenden deklarime as në DVP-në e vitit 2016, në të cilën, në rast se do të pranoni deklarimin në deklaratën *vetting* se gjendja *cash* e ka burimin nga kontrata e lidhur në vitin 2012 do të duhej të shoqërohej me deklarimin për pakësim të gjendjes *cash*, që do të ishte mbartur prej vitit 2015. Mosdeklarimi në asnjë formë për gjendjen *cash*, as në DVP-në 2016, e bën të paprovueshëm deklarimin e subjektit në deklaratën *vetting* se gjendja *cash* prej 10.000 eurosh e ka burimin nga kontrata e shitblerjes. Lexuar këto deklarata, sipas jurisprudencës së konsoliduar të Kolegjit, rreth vlerës provuese të deklaratave periodike, në kuptim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me një peshë të posaçme/të lartë lidhur me provueshmërinë e gjendjes së likuiditeteve në *cash*, referuar si e tillë edhe në ankim, ka çuar pakicën në konkluzionin se qëndron pretendimi i Komisioneres Publike se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë burimin e krijimit të kësaj shume, sipas deklarimeve të saj në deklaratën *vetting* dhe atë periodike të vitit 2015.

5.3. Përveç sa më sipër, pakica, ndryshe nga shumica, ka gjetur të paprovuara dhe të pabesueshme shpjegimet që ka dhënë subjekti për të justifikuar mungesën e deklarimeve, si më sipërshtuar, përgjatë hetimit administrativ. Subjekti, në përgjigje të pyetjeve të shtruara prej Komisionit lidhur me mungesën e deklarimit për gjendjen *cash* të shumës së fituar prej kontratës së mësipërme, ka shpjeguar se pasi kjo shumë është tërhequr prej saj nga llogaria bankare, në datën 14.05.2015, i është dhënë nënës së saj, e cila prej kësaj shume i ka dhuruar subjektit vlerën 10.000 euro, në janar të vitit 2017, shumë e cila është deklaruar në deklaratën *vetting* si gjendje *cash*.

5.4. Pakica e konsideron jobindës dhe kontradiktor në thelb shpjegimin e subjektit të rivlerësimit, për sa i përket burimit të krijimit të kursimeve në *cash* të deklaruar në deklaratën *vetting*. Pakica vlerëson se ka një dallim thelbësor mes burimit të krijimit të rrjedhur nga veprimi juridik i shitblerjes të deklaruar prej subjektit në deklaratën *vetting* dhe në DPV-në e vitit 2015, nga mënyra e fitimit me dhurim, që ajo pretendon si formën/burimin e ri të krijimit, me shpjegimet e dhëna gjatë hetimit administrativ. Në zbatim të dispozitave të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, subjektet e rivlerësimit janë ftuar që në plotësimin e deklaratës *vetting* të deklarojnë saktësisht e plotësisht pasuritë e tyre dhe burimet e krijimit, në këndvështrim edhe të parashikimeve të posaçme të ligjit kur burimet e krijimit të pasurive nuk i përkasin subjekteve, por janë të prejardhura nga persona të tjerë nëpërmjet dhurimit apo huamarrjes. Pretendimi se mosdeklarimi i kësaj forme krijimi të pasurisë është thjesht një lapsus vlerësohet si një mënyrë për të justifikuar mungesën e vijës logjike që duhet të kishin ndjekur deklarimet, të imponuar prej parashikimeve ligjore për gjendjet *cash*, duke deklaruar në fakt një mënyrë krejt të re të fitimit të pasurisë. Këtij arsyetimi i shtohet mungesa e deklarimit për dhurim nga nëna të shumës prej 10.000 eurosh, në DPV-në e vitit 2017, në të cilën duhej të gjente pasqyrim shtesa e pasurisë e krijuar në vitin 2017 dhe burimi i krijimit të saj, nëse ky versioni i pretenduar nga subjekti do të ishte i vërtetë.

5.5. Për të gjitha sa arsyetua më lart, pakica ka vlerësuar se subjekti nuk ka arritur të provojë burimet e ligjshme të krijimit të gjendjes *cash* prej 10.000 eurosh, të deklaruar në deklaratën *vetting*, duke u gjendur, edhe për këtë pasuri, në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme, sipas përcaktimit të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

6. Çështja e tretë, në të cilën kemi ndarë qëndrim të ndryshëm me shumicën lidhet me elemente të analizës financiare të kryer për subjektin e rivlerësimit për periudhën 2003-2016, për të cilët ka pasur pretendime në ankim Komisionerja Publike.

6.1. Lidhur me analizën financiare, Komisionerja Publike, në ankim, ka paraqitur pretendime që lidheshin me përlllogaritjen e shpenzimeve për udhëtim të subjektit dhe të mënyrës së llogaritjes së kursimeve në *cash*, të deklaruara çdo vit në DVP-të respektive. Pakica ka mbajtur qëndrim të ndryshëm nga shumica, në mbështetje të pretendimeve të ngritura nga Komisionerja Publike në ankim, lidhur me përlllogaritjen e shpenzimeve të udhëtimeve për subjektin dhe familjen e saj, e të adresuara në ato udhëtime që subjekti ka pretenduar se i janë financuar prej mikeshës së saj, znj. E. Gj., administratore e agjencisë së udhëtimeve “{***}” ShPK. Komisionerja Publike ka pretenduar në ankim se, *duket se subjekti ka pranuar dhurata në vlerë totale rreth 8.446 euro, për udhëtimet e kryera gjatë periudhës 2009-2019, të cilat ndikojnë në sjelljen e magjistratit jashtë detyrës; Subjekti nuk i ka deklaruar këto dhurime në deklaratimet periodike vjetore, si dhe nuk ka depozituar dokumentacion që provon ofertat me çmim promocial të përfituara nga agjencia turistike, për udhëtimet e kryera prej saj.*

6.2. Pakica, në ndryshim nga shumica, nuk ka njohur si të provuar faktin se shpenzimet e udhëtimit për subjektin dhe familjen e saj janë mbuluar nga shoqëria e mësipërme për vitet 2007, 2011, 2013, 2014 dhe 2015, mbështetur në argumentet si vijon.

6.3. Subjekti ka deklaruar për herë të parë këtë fakt në pyetësorin standard, në përgjigje të pyetjes së Komisionit, nëse ka përfituar dhurata me vlerë më të lartë se 500 euro apo nëse është financuar nga dikush për shpenzime në këtë vlerë apo një vlerë më të lartë. Subjekti i është përgjigjur kësaj pyetje duke shpjeguar se *nga mikeshja ime E. Gj., administratore e “{***}” ShPK., janë financuar, personalisht prej saj, disa nga udhëtimet e mia dhe familjarëve të mi jashtë shtetit, udhëtime në të cilat ka qenë edhe E. dhe/ose familjarë të saj, kjo sipas deklaratës noteriale nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 10.09.2020. Nuk jam në dijeni të shumave të paguara prej saj.* Subjekti nuk ka deklaruar shumat e paguara/shpenzuara për këtë qëllim në deklaratat periodike vjetore dhe as në deklaratën *vetting*, duke pretenduar se ajo nuk ishte në dijeni të shumave të paguara prej kësaj shoqërie.

6.4. Pakica e vlerësoi këtë situatë, *së pari*, në këndvështrim të kualifikimit që do të duhej të kishte marrëdhënia mes subjektit dhe shoqërisë “{***}” ShPK apo administratores së saj, me fokus përfitimet që ka pasur subjekti për shkak të saj. Nisur nga deklaratimet e subjektit, duket se në vite, në mënyrë periodike, kjo shoqëri ka financuar për subjektin dhe familjen e saj shpenzimet e udhëtimit, kryesisht në udhëtime për qëllime turizmi dhe për periudha që tipikisht shkojnë me periudhat e pushimeve vjetore, por jo vetëm, për subjektin dhe familjen. Duket se subjekti ka qenë gjithmonë në dijeni të kësaj situatë, pavarësisht se deklaroi se nuk ka pasur dijeni për shumat e shpenzuara. Gjithashtu, rezulton se për të financuar këto udhëtime, sipas objektit të aktivitetit që ushtron kjo shoqëri, asaj i është dashur të bëjë pagesa të ndryshme për transport, hoteleri e më pas edhe për shpenzimet e nevojshme për ushqim e nevoja të tjera gjatë periudhave që janë kryer këto udhëtime jashtë vendit. Kjo tipologji shpenzimesh, e pretenduar prej subjektit, shfaqet krejt e ndryshme nga mbështetja që japin familjarët apo miqtë në rastet kur presin në shtëpitë tyre, vizitorë nga Shqipëria, përfshi edhe subjekte rivlerësimi, të cilat janë konsideruar prej metodologjisë së Kolegjit si shpenzime që ata kryejnë në kuadrin e ekonomisë së tyre familjare, vetëm për ushqim, ndërsa ofrojnë banesat e tyre pasqyrim për fjetje e për llogaritjen e të cilave zbatohet metodologjia e miratuar me vendimin (JR) nr. 11/2019, datë 22.05.2019, të Kolegjit. Edhe në këto raste, Kolegji ka nënvizuar, mandej në të njëjtin vendim, por edhe në raste të tjera⁵⁸, se çdo rast kur paraqiten këto situata duhen vlerësuar në mënyrë objektive, e kur shpenzimet janë në vlera të konsiderueshme ato duhet të jenë të

⁵⁸ Shih vendimin e Kolegjit (JR) 27/2020.

deklaruar, përndryshe nuk janë njohur si të zbritshme në analizat financiare. Përtej kësaj paranteze, pakica vlerëson se përfitimi në këto terma, për të cilat Komisionerja Publike ka pretenduar një vlerë prej 8.446 eurosh, duhet konsideruar si një marrëdhënie dhurimi, pavarësisht se subjekti këto shuma të shpenzuara nuk i ka përfituar drejtpërdrejtë, por nëpërmjet financimit të udhëtimeve, të cilat, përndryshe do të përballoheshin prej saj.

6.5. Në këto kushte, situata shfaqet e tillë, që, sipas pakicës, subjekti do të duhej të kishte deklaruar këto financime në formularin e deklarimeve periodike, në seksionin e “*Të dhënave konfidenciale, dhuratave dhe trajtimeve preferenciale*”, në të cilën kërkohet që deklaruesit të përshkruajnë llojin e dhuratës, në vlerën mbi 10.000 lekë, si dhe trajtimet preferenciale të pasura nga deklarimi i mëparshëm deri më 31 dhjetor të vitit të deklarimit, në kuptim të nenit 19 të ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar dhe nenit 23 të ligjit nr. 9367/2005, i ndryshuar. Me të njëjtën logjikë, këto vlera/financime/dhurime duheshin deklaruar prej subjektit edhe në deklaratën *vetting*, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, në mënyrë që më pas të kryhej verifikimi i vërtetësisë së këtyre deklarimeve dhe kontrolli i burimeve të krijimit të vlerave të shpenzuara në favor të subjektit. Në këtë kontekst, mungesa e deklarimeve për këto shpenzime në favor të subjektit krijon problematikën *e parë* lidhur me provueshmërinë/besueshmërinë e këtyre rrethanave, në këndvështrim edhe të qëndrimeve të mbajtura prej Kolegjit në raste të ngjashme⁵⁹.

6.6. *Së dyti*, për të provuar pretendimet rreth mbulimit të shpenzimeve për udhëtime prej kësaj shoqërie/administratores së saj, nga analizimi i akteve të administruara gjatë hetimit administrativ, rezulton se subjekti i rivlerësimit, përveç udhëtimeve të financuara nga punëdhënësi, në asnjë rast nuk ka paraqitur dokumente të kohës kur janë realizuar këto udhëtime, që të provojnë apo që japin indicie (siç mund të jenë komunikime me *e-mail* apo rezervime hotelesh apo biletash nga shoqëria “{***}” ShPK, në emër të subjektit), se këto shpenzime mund të jenë mbuluar nga mikja e subjektit znj. Gj. apo nga agjencia e udhëtimeve në pronësi të saj. Akti i parë, në të cilin del në pah se një pjesë e udhëtimeve të subjektit dhe familjes së saj janë financuar nga subjektet më lart, janë përgjigjet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit për pyetësin standard të Komisionit. Aktet e sjella nga subjekti në mbështetje të këtij pretendim janë: (i) “Deklaratë noteriale” me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 10.09.2020, nga mikësja e saj znj. Gj. (në të cilën identifikon udhëtimet në periudhën 2009 - 2017 dhe deklaroi se shpenzimet janë mbuluar prej saj dhe se subjekti nuk ka qenë në dijeni të vlerave monetare të shpenzuara, pasi ia ka bërë dhuratë deklaruesja për shkak të marrëdhënieve shumë të ngushta që kanë); (ii) gjithashtu, me përgjigjet e të njëjtit pyetësor, nga subjekti janë paraqitur 44 vërtetime të lëshuara nga agjencia e udhëtimeve “{***}” ShPK, të cilat mbajnë të gjitha datën 07.10.2020. Në këto vërtetime, sipas rastit, pasqyrohet se kjo *agjenci ka prerë bileta udhëtimi për subjektin dhe familjen e saj*, duke evidentuar vlerën respektive apo ka mbyllur për familjen e subjektit paketa turistike duke dhënë vlerën përkatëse.

6.7. Të gjitha këto vërtetime rezultojnë të jenë të pambështetura me akte që dëshmojnë për pagesa biletash apo pagesa qëndrimi në hotel, për paketa turistike të bëra nga kjo agjenci apo me ndonjë komunikim dokumentar të kohës kur janë realizuar udhëtimet, të cilat të provojnë angazhimin e shoqërisë për të prenotuar dhe paguar udhëtime e paketa turistike për subjektin dhe familjen e saj. Për më tepër, fakti që këto vërtetime, 44 të tilla, janë përpiluar në të njëjtën datë, që përkon edhe me kthimin e përgjigjes së subjektit për pyetësin standard, i bën ato të pabesueshme për vërtetësinë e fakteve që synojnë të provojnë, pasi dukshëm evidentohet nevoja e hartimit të tyre për efekt të procesit dhe sipas nevojë së subjektit dhe jo si pasojë e konsultimit që ka bërë kjo agjenci me dokumentacionin që ajo disponon. Në këtë kontekst, edhe përpjekja e subjektit për të provuar se këto shpenzime janë përballuara prej kësaj shoqërie rezultoi pa efekt në drejtim të krijimit të bindjes se faktet kanë ndodhur siç pretendohet.

⁵⁹ *Shih vendimet e Kolegjit: (JR) 39/2024; (JR)33/2024; (JR) 9/2022 dhe (JR) 11/2019.*

6.8. Përveç sa më sipër, një element tjetër që përforcon qëndrimin për mungesë të provueshmërisë së këtyre deklaramëve janë shpjegimet që ka dhënë subjekti në përgjigje të pyetjeve të kryera në ILDKPKI në datën 07.07.2016, në të cilën pyetjes “A keni kryer udhëtime jashtë shtetit për periudhën 2003 deri në datën 31.12.2014? Nëse po, sa konkretisht dhe sa është shuma e shpenzimeve të kryera?”, subjekti i është përgjigjur: “Për sa i përket udhëtimeve jashtë shtetit ato kanë qenë kryesisht udhëtime pune, por edhe ato që kanë qenë private disa herë kanë qenë ftesa nga miq dhe të afërm ku shpenzimet janë përballuar prej tyre, ndërsa për sa i përket pushimeve ato janë përballuar me shpenzime minimale prandaj nuk janë deklaruar. Si burim për përballimin e këtyre shpenzimeve kanë shërbyer të ardhurat dhe kursimet e deklaruar në deklaratimet e çdo viti”. Sipas këtij shpjegimi, subjekti pranon se shpenzimet për udhëtime e pushimeve, pra, tipikisht ato që deklaroi se janë përballuar prej shoqërisë “{***}” ShPK, janë përballuar prej saj me kursimet e krijuara nga pagat. Në këto kushte, edhe në këtë përgjigje të dhënë nga subjekti pranë ILDKPKI-së, e cila është e afërt me kohën kur u miratua paketa e reformës në drejtësi, rezultoi se nuk ka asnjë të dhënë apo deklaram lidhur me kontributin domethënës e të vazhdueshëm të kësaj shoqërie, të shtrirë gjatë në kohë, lidhur me mbulimin e shpenzimeve të udhëtimeve.

6.9. Mbështetur në këtë arsytim, pakica ka konsideruar të drejtë në parim pretendimin e Komisioneres Publike për përlllogaritjen e shpenzimeve të këtyre udhëtimeve, sipas metodologjisë së Kolegjit. Mbi këtë konkluzion, me ndihmën e Njësisë së Shërbimit Ligjor në Kolegj, u kontrollua analiza financiare e Komisionit, duke mbajtur për kursimet në *cash* dhe çështjet e tjera të njëjtin qëndrim si shumica, si dhe duke modifikuar analizën vetëm në zërin “shpenzime udhëtimi”. Pas këtij kontrolli dhe reflektimit të këtij qëndrimi, rezultoi se shpenzimet e udhëtimit janë në total në vlerën prej 6.088.692 lekësh, përkundrajt vlerës prej 4.743.164 lekësh, që rezultuan nga konkluzioni i shumicës së trupit gjykues në vendim.

6.10. Si pasojë, në reflektimit të kësaj vlere si shpenzim në analizën financiare të subjekti, rezultoi se ajo prodhon balanca negative të ndryshme nga ajo që ka konkluduar shumica, në vitet 2007, 2013 dhe 2014, duke e çuar balancën negative për të gjithë periudhën e rivlerësimit në vlerën (-) 1.601.631 lekë, e cila, për pasojë, e vendos subjektin në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

7. Në përmbledhje të sa arsyetuar më lart, duke konstatuar se subjekti gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të financuar pasurinë e ndodhur në rrugën “{***}”, në Tiranë, pasurinë likuiditet në *cash* të deklaruar në deklaratën *vetting* dhe rezultoi me një balancë negative në analizën financiare të periudhës së rivlerësimit, sipas përcaktimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, në një vlerë negative totale, e cila, sipas jurisprudencës së Kolegjit, kapërcen dukshëm pragun e marrë në konsideratë në zbatim të parimeve të proporcionalitetit dhe objektivitetit, pakica konkludon se subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 e, për rrjedhojë, ndaj saj duhet të vendoset masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

GJYQTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

GJYQTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi